



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

PROPOZICIONET E GARAVE për kategoritë seniore

EDICIONI 2023/2024

Prishtinë, 2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





PËRMBAJTJA

GARAT E BASKETBOLLIT TË FBK-SË.....	5
NENI 1 - DISPOZITAT THEMELORE DHE AKTET NORMATIVE	5
NENI 2 - GARAT E BASKETBOLLIT DHE RREGULLAT ELEMENTARE TË LOJËS SË BASKETBOLLIT	6
NENI 3 - KOMISIONI I GARAVE	8
NENI 4 - SHTOJCAT E PROPOZICIONEVE TË GARAVE	9
NENI 5 - RREGULLAT ZYRTARE TË BASKETBOLLIT	10
NENI 6 - SISTEMI I GARAVE	10
NENI 7 - KALENDARI I GARAVE.....	10
NENI 8 - NUMRI I KLUBEVE PJSËMARRËSE NË GARAT VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE.....	11
NENI 9 - TËRHEQJA E SHORTIT TË NUMRIT GARUES.....	12
NENI 10 - PALESTRAT PËR ZHVILLIMIN E NDESHJEVE	13
NENI 11 - KALENDARI DHE SISTEMI GARUES.....	13
11.1. Superliga e Meshkujve	13
11.2. Superliga e Femrave	15
11.3. Liga e Parë e Femrave	16
11.4. Liga e Parë e Meshkujve	16
11.5. Liga e Dytë e Meshkujve.....	18
NENI 12 - SHTYRJA E NDESHJES	19
NENI 13 - REGJISTRIMI I LOJTARËVE-EVE, E DREJTA PËR TË LUAJTUR.....	20
NENI 14 - LOJTARËT-ET, PAJISJA.....	24
NENI 15 - TRAJNERËT	25
NENI 16 - PERSONAT ZYRTARË TË EKIPIT	26
NENI 17 - KUSHTET E LICENCIMIT TË PËRFAQËSUESIT ZYRTAR TË EKIPIT	28
NENI 18 - DHËNIA E DEKLARATAVE DHE KOMENTIMI I NDARJES SË DREJTËSISË.....	28
ORGANIZIMI PARA FILLIMIT TË NDESHJES.....	30
NENI 19 - ORGANIZIMI I NDESHJES	30
NENI 20 - PALESTRA	32
NENI 21 - LOKALET ZYRTARE.....	33

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 22 - FUSHA E LOJËS	33
NENI 23 - BANKINAT PËR EKIPE.....	34
NENI 24 - TAVOLINA ZYRTARE	35
NENI 25 - SEMAFORI ELEKTRONIK.....	36
NENI 26 - APARATURA PËR 24 SEKONDA.....	36
NENI 27 - TOPI I LOJËS	36
NENI 28 - TEMPERATURA NË PALESTRA	37
NENI 29 - ZËRIMI	37
NENI 30 - REZERVIMET E BILETAVE DHE FTESAVE PËR EKIPIN MYSAFIR DHE ZYRTARËT DHE TË FTUARIT E FBK	38
NENI 31 - OBLIGIMET E EKIPIT MYSAFIR	39
ORGANIZIMI GJATË KOHËS SË NDESHJES	40
NENI 32 - FILLIMI I NDESHJES	40
NENI 33 - RRJEDHA E NDESHJES	41
NENI 34 - GRUPET SIMPATIZUESE, MASKOTA	42
NENI 35 - INSTRUMENTET MUZIKORE.....	43
ORGANIZIMI - PAS PËRFUNDIMIT TË NDESHJES.....	44
NENI 36 - STATISTIKA E NDESHJES.....	44
NENI 37 - VIDEO XHIRIMI	44
NENI 38 - SHPALLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË NDESHJES.....	45
NENI 39 - RAPORTI I VËZHGUESIT/PROTOKOLLI	45
PERSONAT ZYRTARË NË NDESHJE.....	46
NENI 40 - VËZHGUESI.....	46
NENI 41 - GJYQTARËT	48
NENI 42 - GJYQTARËT NDIHMËS	51
NENI 43 - SHPENZIMET E UDHËTIMIT, TAKSAT DHE MËDITJET	52
ANKESA NË NDESHJE	53
NENI 44 - ANKESA NË NDESHJE	53
NENI 45 - ANKESA NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË GARAVE.....	54
NENI 46 - REGJISTRIMI I NDESHJEVE.....	56

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



NENI 47 - MËNYRA E NDARJES SË PIKËVE, PËRCAKTIMI I PLASMANIT	56
DISPOZITAT FINANCIARE	58
NENI 48 - PAGESAT DHE SANKSIONET PËR SHKELJE	58
NENI 49 - ANKESA NË VENDIMIN E SUSPENDIMIT TË KLUBIT	59
SHKELJET DHE DËNIMET	60
NENI 50 - SHKELJET DHE DËNIMET PËR ORGANIZIM TË DOBËT TË NDESHJES	60
NENI 51 - SHKELJET DHE DËNIMET PËR SJELLJE TË SHIKUESVE DHE CENIM TË FUSHËS SË LOJËS	62
NENI 52 - SHKELJET DHE DËNIMET PËR PJSËTARËT E EKIPEVE	65
NENI 53 - PËRBËRJA E EKIPIT	68
NENI 54 - APARATURA E ZËRIMIT, INSTRUMENTET MUZIKORE	69
NENI 55 - MARKETINGU	70
NENI 56 - VËZHguesI, GJYQTARËT DHE GJYQTARËT NDIHMËS	70
NENI 57 - SHQIPTIMI I DËNIMEVE DHE MASAVE TJERA NDËSHKIMORE	72
NENI 58 - REGJISTRIMI I E NDESHJES ME REZULTAT ZYRTAR	73
NENI 59 - NDALESA E PREZENCËS SË SHIKUESVE	75
NENI 60 - EVIDENCA E DËNIMEVE TË SHQIPTUARA	76
NENI 61 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	76

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Në bazë të nenit 23, alineja 1.13 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2023, miratoi:

PROPOZICIONET E GARAVE PËR KATEGORITË SENIORE (EDICIONI 2023/2024)

GARAT E BASKETBOLLIT TË FBK-SË

NENI 1 - DISPOZITAT THEMELORE DHE AKTET NORMATIVE

1.1. Këto Rregulla dhe Propozicione të Garave (në tekstin në vijim Propozicionet apo PG) rregullojnë në mënyrë unike marrëdhëniet ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve në sistemin e garave nën organizim të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK).

1.2. Të gjitha garat zhvillohen nën autorizimin e Bordit të FBK-së dhe në pajtim me Rregullat e Lojës së Basketbollit dhe interpretimet e rregullave të basketbollit të miratuar nga FIBA.

1.3. Të gjitha klubet pjesëmarrëse në sistemin e garave janë të obliguara t'i lexojnë këto Propozicione dhe të bashkëpunojnë me të gjitha organet e FBK-së gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre. Asnjë klub pjesëmarrës në garat e organizuara nga ana e FBK-së nuk ka të drejtë nën asnjë rrethanë:

1.3.1. Që të refuzojë ndeshjen apo të lëshojë fushën e lojës para përfundimit zyrtar të ndeshjes;

1.3.2. Që të refuzojë pjesëmarrjen, apo të lëshojë - braktisë, ceremoninë e hapjes, mbylljes apo ceremoninë e shpalljes së fituesit dhe ndarjes së medaljeve dhe dhuratave në ndeshjet finale.

1.3.3. Që të sillen në mënyrë jo korrekte dhe ofenduese, me çka do të ndikojë në zhvillimin normal të garave, funksionet zyrtare të garave apo ceremonive.

1.4. Të gjitha klubet pjesëmarrëse do t'u përmbahen këtyre Propozicioneve, akteve tjera normative të FBK dhe akteve normative të FIBA përgjatë tërë veprimtarisë së tyre. Të gjitha klubet pjesëmarrëse do të sigurojnë pajtueshmëri me legjislacionin zbatueshëm në Republikën e Kosovës, me vëmendje të veçantë në legjislacionin që rregullon sportin, organizimin e ngjarjeve sportive dhe shmangien e dhunës dhe dukurive negative në sport.

1.5. Të gjitha klubet pjesëmarrëse do të sigurohen që këto Propozicione dhe aktet tjera normative të zbatueshme sipas paragrafit 1.4 më sipër t'u vihen në dispozicion të gjithë pjesëtarëve të tyre, përfshirë lojtarët, shtabin teknik, stafin administrativ dhe ndihmës,

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





kryesitë dhe zyrtarët ekzekutivë të tyre. Klubet pjesëmarrëse do të konsiderohen përgjegjëse për veprimin apo mosveprimin e cilitdo anëtar të vet që bie ndesh me këto Propozicione dhe aktet normative të zbatueshme sipas paragrafit 1.4 më sipër.

1.6. Të gjithë sportistët që përgatiten ose marrin pjesë në një garë ose aktivitet të autorizuar ose organizuar nga FBK ose një nga organizatat anëtare të saj, dhe i gjithë Personeli Mbështetës i Sportistëve, duhet të pranojnë detyrimet që rrjedhin nga Rregullorja për Anti-Doping në Basketboll, dhe t'i nënshtrohen kompetencës së Menaxhimit të Rezultateve dhe KosADA-s dhe organeve tjerë përgjegjëse si kusht për pjesëmarrjen e tillë.

1.7. Këto Propozicione do të caktojnë kushtet themelore për zhvillimin e garave seniore dhe lartësinë e dënimeve, ndalesave, gjobave dhe masave tjera të cilat organet e FBK mund t'i shqiptojnë në rast të shkeljes së tyre nga klubet pjesëmarrëse dhe anëtarët apo tifozët e tyre, nga personat zyrtarë të deleguar në ndeshje, apo nga palë të treta.

1.8. Interpretimin e këtyre Propozicioneve të Garave e bën Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në mënyrë direkte apo nëpërmjet të Komisionit të Garave.

NENI 2 - GARAT E BASKETBOLLIT DHE RREGULLAT ELEMENTARE TË LOJËS SË BASKETBOLLIT

2.1. Garat e basketbollit organizohen për:

2.1.1. Sportistët/et, të cilët aktivitetin e tyre si basketbollistë/e e realizojnë në mënyrë amatore;

2.1.2. Sportistët/et, të cilët aktivitetin e tyre si basketbollistë/e e realizojnë në mënyrë profesionale.

2.2. Asnjë ekip i cili merr pjesë në gara nën organizimin e FBK-së nuk mundet të jetë aksionar në klubin tjetër. Asnjë person fizik ose juridik nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë, në çfarëdo cilësie të marrë pjesë në udhëheqjen administrative ose sportive apo financiare të ndonjë ekipi tjetër, në rang të njëjtë garash. Pronari i ekipit privat nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë të jetë aksionar në dy klube. Përgjashtim bëjnë rastet kur kemi të bëjmë me ekipet e gjinive të ndryshme.

2.3. Rregullat kryesore të lojës së basketbollit, në përputhshmëri të plotë me Rregullat Zyrtare të Basketbollit të FIBA-së, ndër të tjera, janë:

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



2.3.1. Loja e basketbollit zhvillohet në mes dy ekipeve me nga 5 lojtarë. Qëllimi i ekipeve është të shënojnë pikë në koshin e kundërshtarit dh të pengojë skuadrën tjetër të shënojë.

2.3.2. Ndeshja zhvillohet nën kontrollin e 2-3 gjyqtarëve, gjyqtarëve ndihmës, si dhe vëzhguesit të ndeshjes.

2.3.3. Koshi kundërshtar është koshi ku ekipi sulmon, kurse koshi i ekipit është ai që duhet të mbrohet.

2.3.4. Fitues i ndeshjes është skuadra e cila ka shënuar më shumë pikë nga loja në fund të kohës së lojës.

2.3.5. Fusha e lojës duhet të jetë e drejtë dhe pa pengesa, dhe me dimension 28 m gjatësi dhe 15 m gjerësi, e matur nga vijat e brendshme të vijave kufizuese.

2.3.6. Vijat kufizuese duhet të jenë me ngjyrë të bardhë ose ngjyrë dalluese me madhësi 5 cm.

2.3.7. Shënimet jashtë vijës kufizuese 6,75 cm vlejnë 3 pikë, kurse shënimet brenda vijave kufizuese 2 pikë. Gjuajtja e lirë vlen 1 pikë.

2.3.8. Ekipi përbëhet nga:

- Më së shumti 12 lojtarë, përfshirë këtu edhe kapitenin e ekipit, të cilët mund të paraqiten deri në momentin kur shkaktojnë 5 gabime personale;

- Një trajner kryesor; dhe

- Një maksimum prej 8 anëtarësh të delegacionit shoqërues, duke përfshirë asistent-trajnerët që mund të ulen në stolin e ekipit. Në rast se një ekip ka ndihmës trajnerë, ndihmësi i parë i trajnerit do të shënohet në fletën e rezultateve.

2.3.9. Ekipet në ndeshje duhet të paraqiten me uniformë complete të ndeshjeve zyrtare.

2.3.10. Ndeshja udhëhiqet nga trajneri dhe ndihmës trajneri, ku 10 minuta para fillimit të ndeshjes paraqesin 5 startues të ekipit.

2.3.11. Ndeshja përbëhet nga 4 çerek me nga 10 minuta, kurse në rast kur rezultati është i barabartë në fund të ndeshjes, zhvillohet koha shtesë prej 5 minuta, derisa njëra ekip fiton ndeshjen.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





2.3.12. Ndeshja e basketbollit gjithmonë fillon me "jump ball", kurse në çdo çerek tjetër sipas shigjetës së alternuar.

2.3.13. Në ndeshjet e basketbollit ekipet kane në total 5 minuta pushim të cilat mund t'i shfrytëzojnë gjatë gjithë kohës.

2.3.14. Lojtarët gjatë zhvillimit të ndeshjes mund të zëvendësohen gjatë gjithë kohës kur gjyqtari ka përdorur pipin dhe koha është ndalur.

2.3.15. Në ndeshjen e basketbollit mund të shkaktohen shkelje të ndryshme si gabim në hapa, shkelje gjatë driblimit, shkelje të 24, 8 dhe 5 sekondave dhe kthimi i topit në anën e pasme.

2.3.16. Në ndeshjet e basketbollit lojtarët mund të ndëshkohen me gabime personale, gabime josportive, gabime teknike, si dhe gabime diskualifikuese.

2.3.17. Gjyqtarët e ndeshjes janë gjyqtari kryesor, gjyqtari 1 -2 të cilët kanë të drejtë të gjykojnë dhe marrin vendime ndaj lojtarëve të cilët shkaktojnë shkelje dhe gabime duke përdorur pipin e tyre, komunikimin verbal si dhe me shenjat e duarve demonstrojnë numrat si dhe sinjalet e shkeljeve-gabimeve.

NENI 3 - KOMISIONI I GARAVE

3.1. Organi themelor, i cili udhëheq me garat e basketbollit në emër të Federatës së Basketbollit të Kosovës është Komisioni i Garave i FBK-së. Komisioni i Garave themelohet nga Bordi i FBK-së dhe përbëhet nga tre anëtarë (Kryesuesi dhe dy anëtarë të tjerë), të cilët emërohen para fillimit të çdo edicioni (preferohet që të paktën dy prej tyre të jenë ish gjyqtarë ose vëzhgues).

3.2. Në udhëheqje të garave, Komisioni i Garave do t'i zbatojë këto Propozicione, Rregulloren Disiplinore, aktet tjera normative të FBK-së si dhe aktet e FIBA.

3.3. Detyrat themelore të Komisionit të Garave janë, mes tjerash:

3.3.1. Të përgatitë rishikojë dhe rekomandojë Kalendarin e Garave të FBK-së për miratim nga Bordi i FBK-së;

3.3.2. Të udhëheqë, rishikoj dhe mbikëqyrë të gjitha garat zyrtare të FBK-së;

3.3.3. Të përgatitë rekomandime për ndryshime në aspektin e zhvillimit të garave zyrtare;

3.3.4. Të përgatitë rekomandime për prezantim të garave të reja zyrtare;

3.3.5. Të japë këshilla për caktimin e garave zyrtare;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





3.3.6. Të studiojë Rregulloret që i rregullojnë të gjitha garat zyrtare të FBK-së, si dhe të rekomandojë ndryshime për këto Rregullore;

3.3.7. Të sigurojë që interesat specifike dhe zhvillimi i basketbollit të femrave dhe të gjeneratave të reja të merret gjithnjë parasysh kur jepen rekomandime;

3.3.8. Të japë rekomandime në lidhje me transferimet e lojtarëve/eve nga garat e grupmoshave të reja tek seniorët.

3.4. Komesari i Garave në FBK është përgjegjës për delegimin dhe vlerësimin e personave zyrtarë në ndeshje në shkallë të parë. Në rast të kontestimit të vlerësimit të kryer nga Komesari i Garave, ankesa do të trajtohet nga Komisioni i Garave në shkallë të dytë dhe vendimi i nxjerrë sipas ankesës do të konsiderohet përfundimtar. Komisioni i Garave për këtë qëllim mund të angazhojë edhe ekspertizë të jashtme.

3.5. Komesari i Garave do të jetë përgjegjës për komunikimin direkt me personat zyrtarë të deleguar gjatë ndeshjeve. Komunikimi i personave zyrtarë të deleguar në ndeshje me Komisionin e Garave do të jetë i mundshëm vetëm në raste urgjente dhe me kërkesë shprehimore të tyre.

3.6. Komesari i Garave pas përfundimit të të gjitha ndeshjeve të organizuara sipas këtyre Propozicioneve do t'i grumbullojë të gjitha raportet nga vëzhguesit dhe më pas të njëjtat do t'i përcjell tek Komisioni i Garave në email adresën garat@basketbolli.com jo më vonë se 24h pas përfundimit të tyre.

3.7. Komisioni i Garave mund të kërkojë raporte shtesë nga Komesari i Garave, nga zyrtarët e ndeshjeve apo nga cilido akter tjetër, në të gjitha rastet kur kjo është e nevojshme për përmbushjen e mandatit të vet.

NENI 4 - SHTOJCAT E PROPOZICIONEVE TË GARAVE

4.1. Këto Propozicione plotësohen për çdo edicion garues me dokumentet në paragrafin vijues, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse dhe e patjetërsueshme e Propozicioneve. Përgjegjës për miratimin e dokumenteve të përcaktuara në paragrafin 4.2 më poshtë është Bordi Ekzekutiv i FBK-së.

4.2. Për çdo edicion garues publikohen shtojcat e këtyre Propozicioneve të cilat përmbajnë:

4.2.1. Listat e klubeve anëtare të ligave seniore;

4.2.2. Kalendarin i Garave për të gjitha Ligat;

4.2.3. Sistemin i Garave për të gjitha Ligat;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





4.2.4. Lista e Gjyqtarëve për aprovim;

4.2.5. Lista e Vëzhguesve për aprovim; dhe

4.2.6. Lartësia e taksës, mëditjes dhe rrugës për kryerjen e funksionit të gjyqtarëve, vëzhguesve dhe gjyqtarëve ndihmës.

4.3. Bordi i FBK-së ruan të drejtën e miratimit të shtojcave tjera të nevojshme për precizim të mëtejme të këtyre Propozicioneve.

NENI 5 - RREGULLAT ZYRTARE TË BASKETBOLLIT

Garat në FBK do tu nënshtrohen Rregullave Zyrtare të Basketbollit të cilat janë të zbatueshme në momentin e zhvillimit të garave sipas këtyre Propozicioneve e të cilat i miraton dhe publikon Federata Ndërkombëtare e Basketbollit. Në rast të çfarëdo mospërputhjeje mes këtyre Propozicioneve dhe Rregullave Zyrtare të Basketbollit, këto të fundit do të jenë mbizotëruese dhe këto Propozicione do të ndryshohen përkitazi.

NENI 6 - SISTEMI I GARAVE

6.1. Sistemin e Garave dhe mënyrën e plotësimit të ligave e miraton Bordi Ekzekutiv i FBK-së me vendim, në propozim të Komisionit të Garave

6.2. Bordi Ekzekutiv i FBK-së është përgjegjës për të plotësuar vendet e mbetura vakante në ligat e organizuara sipas këtyre Propozicioneve, Kriteve për Licencim dhe akteve tjera normative. Vendimi për plotësimin e vendeve vakante në liga apo për shtimin e numrit të ekipeve garuese në cilindo nivel garimi do të merr parasysh interesin nacional për basketbollin, nivelin organizativ të klubeve pjesëmarrëse dhe kapacitetet e tyre.

NENI 7 - KALENDARI I GARAVE

7.1. Kalendarin e Garave, ndryshimet dhe plotësimet në të gjitha nivelet i përcakton Bordi i FBK-së me propozim të Komisionit të Garave.

7.2. Kalendarin e Garave nuk mund të ndryshohet pas miratimit, përveç nëse është në interes të përzgjedhjeve nacionale apo në rast të pjesëmarrjes së ekipeve në gara ndërkombëtare. Kërkesa për ndryshimin e Kalendarit të Garave duhet t'i dorëzohet Komisionit të Garave, i cili pas miratimit të vet i propozon Bordit Ekzekutiv të FBK-së ndryshimin sipas vlerësimit të tij.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 8 - NUMRI I KLUBEVE PJESËMARRËSE NË GARAT VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

8.1. Të drejtë garimi në garat e organizuara sipas këtyre Propozicioneve kanë vetëm klubet të cilat i kanë përmbushur kriteret për licencim në nivelin përkatës të garimit, i ka kryer të gjitha obligimet financiare ndaj FBK dhe nuk kanë ndalesa tjera zyrtare e ligjore për zhvillimin e veprimtarisë sportive.

8.2. Obligimet ndaj FBK-së për edicionin paraprak duhet të paguhen konform kriterëve për licencim për edicionin e ri të garave, me vendim të Bordit të FBK-së. Vonesa në shlyerje të obligimeve ose mos-përmbushja e marrëveshjes, rezulton me suspendim nga garat dhe aktivitetet e FBK-sw.

8.3. E drejta e garimit të cilitdo anëtar të FBK-së në garat e organizuara nga FBK do t'i mohohet nëse klubi ka çfarëdo borxhi të dokumentuar ndaj FIBA-s, FIBA Evropës, apo ndonjë etniteti tjetër përgjegjës për organizimin e garave ndërkombëtare të basketbollit të njohur nga FIBA.

8.4. Asnjë anëtar i FBK-së nuk do të mund të marrë pjesë në garat e organizuara nga FBK, në rast se FBK është ngarkuar me çfarëdo dënimi, gjobe, pagese, fature apo ngarkesë tjetër si rrjedhojë e veprimit apo mosveprimit të klubit në fjalë kundrejt obligimeve të veta ndaj FIBA, FIBA Evropës, apo cilitdo etniteti tjetër përgjegjës për organizimin e garave ndërkombëtare të njohura nga FIBA. E drejta për të marrë pjesë në gara mund të rifitohet pas kompensimit nga klubi i të gjitha pagesave dhe shpenzimeve të tjera administrative, të cilat i janë ngarkuar FBK-së si rrjedhojë e veprimit apo mosveprimit të klubit sipas këtij paragrafi.

8.5. Klubet në garat shtetërore (Superliga, Superliga e Femrave, Liga e Parë Femrave, Liga e Parë e Meshkujve dhe Liga e Dytë e Meshkujve) janë të obliguara që t'i pranojnë dhe t'i zbatojnë Rregullat dhe Propozicionet e Garave, sistemin e garave si dhe aktet tjera normative të FBK-së.

8.6. Në garat shtetërore klubet paraqiten nën emrin zyrtar, gjegjësisht nën emrin e tyre të regjistruar. Pranë emrit zyrtar, klubet mund të përdorin edhe emrin e sponsorit dhe atë në gara, medime, në punët komerciale dhe rastet tjera për të cilën do të lajmërojnë me shkrim Komisionin e Garave para fillimit të edicionit.

8.7. Në rast se Klubi i cili është shpallur kampion apo fitues i Kupës së Kosovës nuk dëshiron të merr pjesë në garat evropiane përkatëse, me vendim të posaçëm të Bordit të

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FBK-së përcaktohen ekipet, të cilat do të marrin pjesë në gara ndërkombëtare pas përmbushjes së kriterëve të përcaktuara nga ana e Bordit.

8.8. Në zbatim të paragrafit paraprak, me kusht të plotësisimit të kushteve dhe kriterëve tjerë, do të garantohen përfaqësimet në vijim:

8.8.1. Fituesit e titullit të kampionit në nivel të Superligave do të fitojnë të drejtën e garimit në nivelin më të lartë të garimit evropian që i ofrohet FBK-së;

8.8.2. Fituesit e titullit të Kupës së Kosovës në nivel të seniorëve do të fitojnë të drejtën e garimit në nivelin e dytë të garimit evropian që i ofrohet FBK-së;

8.8.3. Katër ekipet e propozuara nga Bordi i FBK-së në stinorin paraprak në Superligën e Kosovës dhe tri ekipet e ranguar të parat në stinorin paraprak në Superligën e Femrave do të fitojnë të drejtën e garimit në Ligën Unike.

8.9. Në rast të shfaqjes së mundësisë së përfaqësimit shtesë të klubeve kosovare në liga evropiane apo rajonale, Bordi i FBK-së do të vendosë me vendim të posaçëm për këtë, duke u bazuar në parimet e meritës dhe rezultateve sportive të arritura.

8.10. Në raste të shfaqjes së fuqisë madhore, përfshirë mes tjerash fatkeqësitë natyrore, epidemitë dhe pandemitë, gjendjen e jashtëzakonshme të shprehur apo të nënkuptuar, si dhe çfarëdo situatë të ngjashme që rezulton me nevojën për të ndërprerë garat, Bordi i FBK-së mund të bëjë ndryshimin emergjent të këtyre Propozicioneve të Garave dhe sistemit të garave, duke interpretuar situatën e krijuar dhe vendosur në baza meritore për pezullimin, ndërprerjen e plotë, ndërprerjen e përsëritshme, ri programimin e garave, anulimin e tërësishëm të edicionit, apo ri përcaktimin e kalendarit të garave apo terminëve të zhvillimit të ndeshjeve, përfshirë edhe marrjen e vendimit për shpalljen e renditjes tabelare përfundimtare për secilin nivel të garave dhe ngritjen apo rënien nga niveli i garave.

NENI 9 - TËRHEQJA E SHORTIT TË NUMRIT GARUES

9.1. Para fillimit të edicionit të garave, bëhet tërheqja e numrit të ekipit për garat e ligës.

9.2. Tërheqja e shortit bëhet në praninë e përfaqësuesve të ekipeve, që do të ftohen të marrin pjesë në ligën për të cilën tërhiqet shorti.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 10 - PALESTRAT PËR ZHVILLIMIN E NDESHJEVE

10.1. Çdo klub është i obliguar që më së largu 14 ditë para fillimit të garave të paraqes palestrën në të cilën do të zhvillojë ndeshjet si vendës dhe palestrën alternative, si dhe të bëhet inspektimi teknik i palestrës dhe pajisjeve përcjellëse. Pranimin e palestrës e bënë Komisioni i Garave.

10.2. Në palestrat ku zhvillohen ndeshjet e kategorive senior/e në tabelat e konstruksionit të koshave duhet të vendosen LED DRITAT të aprovuara nga FIBA për përfundimin e kohës së sulmit (E VERDHË) dhe kohës së ndeshjes (E KUQE), që në rastet diskutabile gjyqtarët mund të vendosin për ndërhyrjen e fundit. Kur tabelat janë të pajisura me LED ndriçim e verdhë (skadim i 24 sekondave) dhe LED ndriçimin e kuq (skadim i kohës së çerekut apo të kohës shtesë) ky ndriçim ka përparësi në raport nga sinjali i zërit të kohës së lojës.

NENI 11 - KALENDARI DHE SISTEMI GARUES

Ndeshjet zhvillohen sipas kalendarit të garave të përcaktuara më parë për çdo ligë veç e veç dhe atë nën kushtet e përcaktuara në vijim:

11.1. SUPERLIGA E MESHKUJVE

11.1.1. Në edicionin garues 2023/2024 Superliga e Meshkujve do të përbëhet nga tetë (8) skuadra: KB Bashkimi, KB Golden Eagle Ylli, KB Istogu, KB Peja, KB Proton Cable Prizreni, KB Sigal Prishtina, KB Trepça dhe KB Vëllaznimi, të cilat e kanë fituar të drejtën e garimit në nivelin më të lartë garues.

11.1.2. Çdo ekip i Superligës për Meshkuj për edicionin 2023/24 është i obliguar që më ekipet e U14, U16, U18 dhe U12 të marrë pjesë në garat e Federatës për grup-moshat e reja. Lojtarët nën moshën 18 vjeçare të regjistruar në ekipin e Superligës mund të paraqiten vetëm në ekipet zinxhir të të njëjtit ekip.

11.1.3. Para fillimit të edicionit garues 2023/24 do të zhvillohen ndeshjet e Superkupës së Kosovës në formë të turneut me pjesëmarrjen e tetë skuadrave të Superligës. Turneu do të zhvillohet në vendin ku e përcakton me vendim Bordi i FBK-së. Orari ndeshjeve do të jetë e Mërkurë - Diel. Sistemi i zhvillimit të ndeshjeve të Superkupës do të ishte sipas renditjes përfundimtare ku fituesi i Kupës (KB Trepça) dhe kampioni i Kosovës për edicionin 2022-2023 (KB Peja) do të ndeshen vetëm nëse arrijnë të kualifikohen në finale.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





11.1.4. Superliga e Meshkujve do të zhvillohet me sistem të dyfishtë të garave (vajtje-ardhje) në pjesën vjeshtore dhe sistem të dyfishtë (vajtje-ardhje) në pjesën pranverore. Pas përfundimit të edicionit të rregullt (28 xhiro) gjashtë ekipet e para plasohen në play-off. Në çerekfinale do të ndeshen 3-6 dhe 4-5 deri në dy fitore (maksimumi 3 ndeshje), kurse ekipet e renditura në pozitat 1 dhe 2 në raundin e parë do të pauzojnë dhe në gjysmëfinale do të takohen me ekipet nga renditja 3/4/5/6. Ndeshjet e play off-it do të zhvillohen e mërkurë/enjte dhe shtunë/diel në vazhdimësi pa ndërprerje nëse nuk vjen deri te zhvillimi i ndeshjes së fundit konform PG.

11.1.5. Gjysmëfinalet e play-offit zhvillohen sipas formulës 1 vs 4-5, 2 vs 3-6. Plasmanin në finale e siguron ekipi që i pari arrin tri (3) fitore. Gjysmëfinalet zhvillohen sipas formatit vajtje - ardhje dhe epërsinë e terrenit vendës e ka ekipi më lartë i plasuar në edicionin e rregullt.

11.1.6. Në finale të play-offit takohen ekipet fituese të gjysmëfinaleve. Kampion i Superligës shpallet ekipi që i pari arrin tri (3) fitore. Finalja e play-offit zhvillohet sipas formatit vajtje - ardhje. Përparësinë e terrenit vendës e ka ekipi që ka qenë më mirë i ranguar në edicionin e rregullt dhe luan si vendas në ndeshjet 1 dhe 3 dhe ndeshjen eventuale 5. Ndeshjet e play off-it do të zhvillohen të mërkurë/enjten dhe shtunë/diel në vazhdimësi pa ndërprerje nëse nuk vjen deri te zhvillimi i ndeshjes së fundit konform PG.

11.1.7. Skuadra e cila renditet si e shtata në tabelë në fund të edicionit të rregullt do të luajë në play-out me finalistin e Ligës së Parë në dy ndeshje dhe anëtar i Superligës së Kosovës do të (mbetet ose) do të shpallet ekipi, i cili nga dy ndeshjet ka rezultatin më të mirë në koshdallim. Zhvillimin e ndeshjes së dytë të play out-it do ta bëjë ekipi i cili është renditur si i parafundit në Superligë.

11.1.8. Skuadra e renditur në vendin e tetë (8) në fund të edicionit të rregullt të garave (28 xhirove) largohet në Ligën e Parë.

11.1.9. Në edicionin 2023/24 tek Superliga e Meshkujve do të aplikohet një (1) Coach's challenge/Sfida e Trajnerit (sipas rregullave zyrtare të basketbollit).

11.1.10. Në të gjitha palestrat, në të cilat zhvillohen ndeshjet e Superligës duhet të jetë e instaluar internet lidhja me shpejtësi prej së paku 30/10.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





11.2. SUPERLIGA E FEMRAVE

11.2.1. Për edicionin 2023/2024 përbëhet prej 6 (gjashtë) ekipeve të cilat kanë fituar të drejtën në bazë të rezultateve të edicionit 2022/2023: KBF Bashkimi, KBF Prishtina, KBF Penza, KBF Peja 03, KBF Trepça dhe KBF United Basketball.

11.2.2. Çdo ekip i Superligës për Femra për edicionin 2023/24 është i obliguar që më ekipet e U16 dhe U18 të marrë pjesë në garat e Federatës për grup-moshat e reja. Lojtarët nën moshën 18 vjeçare të regjistruara në ekipin e Superligës mund të paraqiten vetëm në ekipet zinxhir të të njëjtit ekip.

11.2.3. Para fillimit të edicionit 2023/2024 do të zhvillohen ndeshjet e Superkupës së Kosovës në formë të turneut me pjesëmarrjen e katër skuadrave të Superligës. Turneu mund të zhvillohet në qytetin ku ekipi organizator është pjesëmarrës dhe ku të cilin e përcakton me vendim Bordi i FBK-së.

11.2.4. Sistemi i zhvillimit të ndeshjeve të Superkupës do të ishte sipas renditjes përfundimtare ku (në këtë rast) finalisti i Kupës (KBF Prishtina) dhe kampioni i Kosovës për edicionin 2022/2023 (KBF Bashkimi) do të ndesheshin vetëm nëse arrijnë të kualifikohen në finale.

11.2.5. Sistemi i garave do të duhej të zhvillohet me sistem të katërfishtë të garave (vajtje-ardhje). Pas përfundimit të edicionit të rregullt (20 xhiro) katër ekipet e para plasohen në play-off, ekipi i cili është i fundit do të largohet nga Superliga. Ndeshjet gjysmëfinale do të zhvillohen 1-4 dhe 2-3 deri në 2 fitore (maksimumi 3 ndeshje), si dhe ndeshjet finale në 3 fitore (maksimumi 5 ndeshje).

11.2.6. Me përfundimin e gjysmëfinaleve, në rast të eliminimit të ekipit më lartë të plasuar (1), skuadra më poshtë e plasuar (4) zë vendin e asaj skuadre (1) dhe fiton përparësinë e terrenit vendës për zhvillimin e ndeshjeve finale të play-offit 1 dhe 3 dhe eventualisht 5.

11.2.7. Në edicionin 2023/24 tek Superliga e Femrave do të aplikohet një (1) Coach's challenge/Sfida e Trajnerit (sipas rregullave zyrtare të basketbollit), në ato ndeshje ku transmetimi i ndeshjes bëhet live nga Kujtesa/Art Motion.

11.2.8. Ndeshjet të cilat do të transmetohen Live nga Kujtesa/Art Motion do të zhvillohen të Premten nga ora 17:00 ose 19:00 dhe ndeshjet tjera të shtunën/diel nga ora 16:00 dhe të mërkurën/enjte varësisht nga kalendari i garave, nga ora 17:00 - 20:00.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





11.3. LIGA E PARË E FEMRAVE

11.3.1. Për edicionin 2023/2024 përbëhet prej ekipeve pjesëmarrëse të vitit të kaluar: KBF Vëllaznimi, KBF AA Prishtina, KBF Istogu, KBF Drita, KBF Vushtrria, KBF Junior 06. Për këtë rang ekipet do të bëjnë gara me sistem të dyfishtë (vajtje - ardhje), kurse pas përfundimit të edicionit të rregullt, katër ekipet më së miri të ranguar në tabelë, do të plasohen në play-off.

11.3.2. Çdo ekip i Ligës së Parë të Femrave për edicionin 2023/24 është i obliguar që më ekipet e U14 të marrë pjesë në garat e Federatës për grup-moshat e reja. Lojtarët nën moshën 18 vjeçare të regjistruara në ekipin e Ligës së Parë mund të paraqiten vetëm në ekipet zinxhir të të njëjtit ekip.

11.3.3. Në gjysmëfinale do të takohen ekipet 1-4, dhe 2-3 deri në dy fitore (maksimum tri ndeshje). Kampion i Ligës së Parë të Femrave do të shpallet skuadra, e cila së pari arrin në 2 fitore (maksimumi tri ndeshje) dhe në edicionin 2022 -2023 do të fitojë të drejtën të garojë në Superligën e Femrave.

11.3.4. Me përfundimin e gjysmëfinaleve, në rast të eliminimit të ekipit më lartë të plasuar (1), skuadra më poshtë e plasuar (4) zë vendin e asaj skuadre (1) dhe fiton përparësinë e terrenit vendës për zhvillimin e ndeshjeve finale të play-offit 1 dhe 3.

11.4. LIGA E PARË E MESHKUJVE

11.4.1. Në edicionin garues 2023/2024 Liga e Parë e Meshkujve do të përbehet prej dhjetë ekipeve: KB Rahoveci, KB Bora, KB Kerasan, KB AS Prishtina, KB Borea, KB Vushtrria, KB Kosovari, KB New Basket, KB Drita dhe KB Gjakova e Re.

11.4.2. Çdo ekip i Ligës së Parë të Meshkuj për edicionin 2023/24 është i obliguar që më ekipet e U14 dhe U16 ose 18 të marrë pjesë në garat e Federatës për grup-moshat e reja. Lojtarët nën moshën 18 vjeçare të regjistruar në ekipin e Ligës së Parë mund të paraqiten vetëm në ekipet zinxhir të të njëjtit ekip.

11.4.3. Sistemi i garave në sezonin e rregullt është i trefishtë. Në ciklin e parë luhet sistem i dyfishtë vajtje-ardhje. Në ciklin e dytë, në bazë të renditjes së ekipeve hartohet kalendari për xhirot e fundit në bazë të sistemit të Bergerit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





11.4.4. Çdo ekip duhet t'i ketë 7 lojtarë të lindur më 2002 ose më të rinj në Listën Paraqitëse nëse ka të paraqitur 12 lojtarë, 7 lojtarë nëse ka të paraqitur 11 lojtarë dhe 7 lojtarë nëse ka të paraqitur 10 lojtarë.

11.4.5. Ekipet e Ligës së Parë kanë të drejtë licencimi të dyfishtë lojtarë të lindur nga viti 2003 ose më të rinj (të Superligës) për tu paraqitur në Ligën e Parë. Ekipet e Ligës së Parë janë të OBLIGUARA që në total të kenë 40 minuta në lojë lojtarët (2 lojtarë e më shumë) e lindur më të ri se viti 2003.

11.4.6. Një ekip mund të ketë më së shumti katër (4) lojtarë me licencë të dyfishtë gjatë një edicioni garues. Lojtarët me licencë të dyfishtë mbetën lojtarë të ekipeve të Superligës dhe nuk mund të paraqiten brenda ditës në dy ndeshje të ligave të ndryshme.

11.4.7. Në edicionin 2023/24 tek Liga e Parë e Meshkujve do të aplikohet një (1) Coach's challenge/Sfida e Trajnerit (sipas rregullave zyrtare të basketbollit) në ato ndeshje ku transmetimi i ndeshjes bëhet live nga Kujtesa/Art Motion.

11.4.8. Pas përfundimit të edicionit të rregullt, katër ekipet më së miri të ranguar në tabelë do të plasohen në play-off. Në gjysmëfinale do të takohen ekipet 1-4, dhe 2-3 deri në dy fitore (maksimum tri ndeshje). Kampioni i Ligës së Parë do të shpallet ekipi i cili së pari arrin në dy fitore (maksimumi tri ndeshje).

11.4.9. Me përfundimin e gjysmëfinaleve, në rast të eliminimit të ekipit më lartë të plasuar (1), skuadra më poshtë e plasuar (4) zë vendin e asaj skuadre (1) dhe fiton përparësinë e terrenit vendës për zhvillimin e ndeshjeve finale të play-offit 1 dhe 3.

11.4.10. Skuadra finaliste e Ligës së Parë do të luaj në play-out me ekipin e 7 të renditur në Superligë deri në dy ndeshje dhe anëtar i Superligës shpallet ekipi i cili nga dy ndeshjet ka rezultatin më të mirë në koshdallim.

11.4.11. Ekipi i cili është renditur si i 9-ti në tabelën e klasifikimit në fund të edicionit të rregullt do të zhvillojë ndeshjen në Play Out me finalistin e Ligës së Dytë, kurse skuadra e cila është e renditur si e dhjeta (10) pas sezonit të rregullt largohet në Ligën e Dytë të Kosovës në basketboll. Zhvillimin e ndeshjes së dytë të Play Out-it do ta bëjë ekipi i cili është renditur si i parafundit në Ligën e Parë.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





11.5. LIGA E DYTË E MESHKUJVE

11.5.1. Për edicionin 2023/2024 përbëhet prej 10 ekipeve pjesëmarrëse nga edicioni i kaluar: KB KEKU, KB Happy Dukagjini, KB Llapi, KB Megasport, KB Gjakova, KB Sfera, KB Lipjani, KB Kaçaniku dhe KB Grapeland.

11.5.2. Për këtë rang ekipet do të bëjnë gara me sistem të dyfishtë (vajtje-ardhje) gjithsej 14 xhiro, kurse pas përfundimit të edicionit të rregullt, katër ekipet më së miri të ranguar në tabelë do të plasohen në play-off. Në gjysmëfinale do të takohen ekipet 1-4 , dhe 2-3 deri në dy fitore (maksimum tri ndeshje).

11.5.3. Me përfundimin e gjysmëfinaleve, në rast të eliminimit të ekipit më lartë të plasuar (1), skuadra më poshtë e plasuar (4) zë vendin e asaj skuadre (1) dhe fiton përparësinë e terrenit vendës për zhvillimin e ndeshjeve finale të play-offit 1 dhe 3.

11.5.4. Kampion i Ligës së Dytë do të shpallet skuadra, e cila së pari arrin në 2 fitore (maksimumi tri ndeshje) dhe në edicionin 2023 -2024 do të garojë në Ligën e Parë. Skuadra finaliste e Ligës së Dytë do të luaj në play-out me ekipin e 9 të renditur në Ligën e Parë deri në dy ndeshje dhe anëtar i Ligës së Parë shpallet ekipi i cili nga dy ndeshjet ka rezultatin më të mirë në koshëdallim.

11.5.5. Zhvillimin e ndeshjes së dytë të play out-it do ta bëjë ekipi i cili është renditur si i parafundit në Ligën e Parë.

TË PËRGJITHSHME

11.6. Skuadra vendëse është e obliguar të bëjë paraqitjen e vendit (Superliga Femrat, Liga e Parë, Liga e Parë- Femrat dhe Liga e Dytë), ditës dhe orës së zhvillimit të ndeshjes më së paku 72 orë para zhvillimit të saj. Paraqitja me shkrim i bëhet Komesarit të Garave në adresën elektronike komesari@basketbolli.com.

11.7. Për klubet pjesëmarrëse në Superligën e Kosovës në basketboll, platformat KUJTESA dhe ART Motion si partnerë medial të FBK-së në bashkërendim me FBK-në do të bëjnë formulimin e orarit të ndeshjeve të Superligës së Kosovës për edicionin 2023/2024, duke iu përmbajtur parimeve të përcaktuara në këtë paragraf:

11.7.1. Terminet e fillimit të ndeshjeve për gara kampionale të Superligës së Meshkujve mund të jenë në ora 17:00 dhe 19:00 të çdo dite të miratuar sipas kalendarit;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





11.7.2. Terminet e fillimit të ndeshjeve të Ligës së Parë duhet të jenë mes orës 16:00 dhe 20:30 gjatë ditëve të miratuara sipas kalendarit dhe më herët me marrëveshje mes dy klubeve;

11.8. Ndeshjet mund të zhvillohen edhe në terminë tjera, me lejimin shprehimor paraprak me shkrim nga ana e Komisionit të Garave për arsyet në vijim:

11.8.1. Për transmetimin e ndeshjeve në TV;

11.8.2. Me marrëveshje të ekipeve në mungesë të terminit. Nëse kërkohet që kjo ndeshje të zhvillohet jashtë javës së rregullt sipas kalendarit të garave, e njëjta duhet të zhvillohet (me lejimin me shkrim nga Komisioni i Garave) para fillimit të javës së ardhshme kalendarike për shkak të mbarëvajtjes së rregullt të garave.

11.9. Datat dhe terminet e ndeshjeve të play-off-it dhe play-out-it do të përcaktohen para fillimit të edicionit garues.

11.10. Në pjesën përfundimtare të edicionit garues, nëse është nevoja, Komisioni i Garave mund të caktojë që disa ndeshje apo të gjitha ndeshjet e xhiros së njëjtë të zhvillohen në ditën dhe orën e njëjtë. Ky Vendim do t'u komunikohet klubeve jo më vonë se 48 orë para terminit të fillimit të ndeshjes nëpërmjet adresës elektronike.

11.11. Sëmundja apo pamundësia e paraqitjes në ndeshje të lojtarëve dhe trajnerëve, zhvillimi i ndeshjeve miqësore apo turneve në vend dhe jashtë vendit, problemet me transport etj., nuk janë raste të arsyeshme për shtyrjen e ndeshjes. Shtyrja e ndeshjes mund të aprovohet me pëlqimin e të dy ekipeve dhe me lejimin e Komisionit të Garave.

NENI 12 - SHTYRJA E NDESHJES

12.1. Komisioni i Garave mund të marrë vendim për shtyrjen e ndeshjes në kërkesë të ekipit që gjatë javës do të zhvillojë ndeshjen e ligës ndërkombëtare por e njëjta duhet të zhvillohet më së largu gjatë javës së ardhshme kalendarike (14 ditë), përveçse si është e cekur në Nenin 7.2. Ndeshjet e shtyra edhe nëse vjen deri te ndryshimi në Rosterin e ekipeve do të zhvillohen me Rosterin aktual të cilin ekipet e kanë në momentin kur është dashur të zhvillohet sipas kalendarit ndeshje e mbetur.

12.2. Ndeshjet që zhvillohen si ndeshje të mbetura, të drejtë të paraqitjes kanë vetëm lojtarët që janë licencuar te klubi deri në ditën e ndeshjes sipas Kalendarit të Garave. Lojtarët që janë licencuar pas datës së paraqitjes nuk kanë të drejtë të performojnë ndeshjet sipas Kalendarit të Garave, si dhe ata lojtarë që ndërkohë janë larguar nga klubi.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:





12.3. Nëse ndeshja nuk mund të zhvillohet në terminin e caktuar apo është ndërprerë për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike në pjesë ku gjendet palestra, ndërprerjes së komunikacionit, fatkeqësive nga moti i lig të vërtetuara organet zyrtare, situatat e përcaktuara me ligj për fatkeqësitë natyrore (zjarri, përmytjet, rreziku, etj.), ndeshja duhet të zhvillohet brenda 24 orëve. Vendimin mbi shtyrjen e ndeshjes për 24 orë e merr vëzhguesi i ndeshjes apo në mungesë të tij Gjyqtari i Parë, duke u bazuar në këtë nen.

12.4. Ndeshja e ndërprerë për raste të arsyeshme (fatkeqësitë natyrore) do të vazhdohet nga koha dhe rezultati në momentin e ndërprerjes së ndeshjes, si dhe me të gjitha të dhënat nga protokollin e ndeshjes së ndërprerë.

12.5. Nëse të dy ekipet nuk paraqiten në fushë në kohën e caktuar për të zhvilluar ndeshjen, pa paralajmërimin e Komisionit të Garave për shkaqet e mos zhvillimit të ndeshjes, ndeshja nuk do të zhvillohet kurse të dy ekipet nuk do të marrin nga një pikë sipas rregullit me rastin e humbjes së ndeshjes.

12.6. Shtyrja e ndeshjeve si rrjedhojë e mosplotësimit të kushteve elementare nga ana e nikoqirit do të rregullohet me nen të veçantë brenda këtyre Propozicioneve dhe me aktet tjera normative të FBK-së.

12.7. Klubi, lojtari (lojtarët) apo trajneri i të cilit merr pjesë (marrin pjesë) në përbërje të cilësdo Përzgjedhje Nacionale, ka të drejtë të kërkojë të shtyjë ndeshjen kampionale apo të Kupës. Për shtyrjen eventuale të ndeshjes, vendos Komisioni i Garave, në bazë të këtyre Propozicioneve.

NENI 13 - REGJISTRIMI I LOJTARËVE-EVE, E DREJTA PËR TË LUAJTUR

13.1. Në ndeshje mund të paraqiten vetëm lojtarët-et të cilët (cilat) kanë kartelën garuese-licencën MAP (të regjistruar në platformën **regjistrohu.club**) e lëshuar dhe vërtetuar nga ana e organit të autorizuar nga FBK (Komisionit të Garave), me kusht që lojtari (lojtarja) të ketë përmbushur të gjitha obligimet tjera dhe të mos jetë i/e suspenduar apo në vuajtje të dënimit.

13.2. Në ndeshje, një ekip mund të paraqes më së shumti 12 (dymbëdhjetë) lojtarë-e dhe jo më pak se 10 (dhjetë).

13.3. Kontrollimi mjekësor i lojtarëve-eve është i obliguar të kryhet dy herë gjatë një edicioni garues, para fillimit të pjesës së parë dhe të dytë të tij. Lojtari (lojtarja) që nuk e ka

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





kaluar kontrollimin mjekësor nuk ka të drejtë të paraqitet në ndeshje. Vërtetimi mjekësor sipas këtij paragrafi duhet t'i dorëzohet Komisionit të Garave para fillimit të ndeshjes, si parakusht për licencim dhe rilicencim të lojtarit/es.

13.4. Klubet janë të obliguara që në ndeshje të paraqiten me përbërje më të mirë. Për mosrespektimin e kësaj pike, trajneri dhe personi zyrtar (përfaqësuesi zyrtar apo kryetari) i klubit do t'i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore. Këtu përfshihet edhe obligimi i Klubit të mos lirojë lojtarin me kontratë valide deri në përfundimin e lojës së fundit të edicionit garues.

13.5. Në edicionin garues të Prince Caffè Superligës 2023/2024 çdo ekip duhet të ketë në përbërje më së paku 2 lojtarë vendorë (homegrown; nuk përfshin lojtarët e natyralizuar) të lindur në vitin 2003-2004 ose më të rinj. Obligimi sipas këtij paragrafi është i zbatueshëm për të gjitha ndeshjet e zhvilluara sipas këtyre Propozicioneve, si dhe për ndeshjet e Superkupës, Kupës dhe Play-offit. Klubet që për gjatë tërë edicionit 2023/2024 nuk dëshirojnë të respektojnë këtë detyrim duhet të paguajnë shumën prej 5,000.00 EUR në llogari të FBK-së për zhvillimin e gjeneratave të reja dhe me këtë do të lirohen nga ky detyrim.

13.6. Në rast të mosrespektimit të nenit 13.5 nga klubet të cilat nuk e kanë përzgjedhur opsionin e pagesës sipas nenit 13.6, Klubet pjesëmarrëse:

13.6.1. Në rastin e parë do të dënohet me para në shumë prej 400.00€.

13.6.2. Me rastin e përsëritjes do të dënohet me para në shumë prej 800.00€.

13.7. Regjistrimi i lojtarëve vendor dhe procedurat e transferimit të tyre precizohen në Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të Lojtarëve të FBK-së.

13.8. Ekipe të Superligës së Meshkujve kanë të drejtë të mbajnë në regjistrin e lojtarëve (MAP) të huaj deri në gjashtë lojtarë të huaj, ndërsa në listën paraqitëse të ndeshjes në secilën ndeshje duhet të paraqesin me më se paku:

13.8.1. Pesë lojtarë vendorë nëse ekipi ka 10 lojtarë në listën paraqitëse, prej tyre dy të lindur nga 2004 e më të rinj;

13.8.2. Gjashtë lojtarë vendorë nëse ekipi ka 11 lojtarë në listën paraqitëse, prej tyre dy të lindur nga 2004 ose më të rinj;

13.8.3. Shtatë lojtarë vendorë nëse ekipi ka 12 lojtarë në listën paraqitëse, prej tyre dy të lindur nga 2004 ose më të rinj.

13.9. Të gjitha ekipe të garave senior/e para fillimit të ndeshjes janë të obliguar që paralelisht të paraqesin MAP dhe listën paraqitëse 45 minuta para fillimit të ndeshjes tek

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





vëzhguesi i ndeshjes. Mos-respektimi i kësaj alineje (13.9) do të dënohet sipas dispozitave të këtyre Propozicioneve.

13.10. Në rast se ekipi i Superligës së Meshkujve ka të regjistruar më shumë se pesë lojtarë të huaj në regjistrin e lojtarëve (MAP), i njëjti obligohet që ta njoftojë Komesarin e Garave me shkrim mbi pesë lojtarët të cilët do të paraqiten në ndeshjen e radhës jo më vonë se 12h para fillimit të ndeshjes. Në rast se ekipi dështon të paraqesë këtë njoftim me shkrim brenda afatit të përcaktuar në këtë paragraf, do të dënohet sipas dispozitave të këtyre Propozicioneve.

13.11. Ekipet e Superligës së Meshkujve kanë të drejtë të aktivizojnë deri në tre lojtarë të huaj në parket gjatë cilitdo interval të ndeshjes, ndërsa lojtarët tjerë të mundshëm në listën paraqitëse (lojtari i katërt dhe i pestë) mund të jenë zëvendësues. Hyrja e rastësishme e lojtarit të katërt të huaj në ndeshje do të sanksionohet me gabim teknik (B) për trajnerin e skuadrës që ka kryer shkelje të këtij paragrafi.

13.12. Ekipet e Superligës së Femrave kanë të drejtë të regjistrojnë deri në tri lojtare të huaja, ndërsa të aktivizojnë deri në dy lojtare të huaja në parket gjatë cilitdo interval të ndeshjes, ndërsa lojtarja e tretë e mundshme në listën paraqitëse mund të jetë zëvendësuese. Hyrja e rastësishme e lojtares së tretë të huaj në ndeshje të cilat do të organizohen sipas këtyre Propozicioneve do të sanksionohet me gabim teknik (B) për trajnerin e skuadrës që ka kryer shkelje të këtij paragrafi. Aktivizimi i lojtares së tretë të huaj për qëllime të pjesëmarrjes në gara ndërkombëtare është i lejuar pa kufizime.

13.13. Ekipet bartin përgjegjësi për paraqitjen e të gjitha dokumenteve të përcaktuara në këtë paragraf dhe me rregulloren përkatëse për Regjistrim dhe Kalim në FBK-së si parakusht për regjistrimin e lojtarëve të huaj. Mosparaqitja e dokumenteve të plota, të sakta dhe mos-përmbushja e obligimeve të regjistrimit do të rezultojë me moslejimin e paraqitjes së lojtarëve të huaj në ndeshjet e organizuara sipas këtyre Propozicioneve. Kushtet për regjistrimin e lojtarëve të huaj janë:

- 13.13.1.** Formularin dhe fletëregjistrimin FA 3 të plotësuar në tërësi;
- 13.13.2.** Kopje të skanuar të pasaportës së lojtarit;
- 13.13.3.** Informatat mbi emrin dhe numrin e licencës së agjentit dhe agjencisë që përfaqëson lojtarin;
- 13.13.4.** Fletë-lëshimi zyrtar i nxjerrë nga sistemi i FIBA, për procesimin e së cilit duhet të pritët deri në 14 ditë;
- 13.13.5.** Kopja e kontratës së ekipit me lojtarin;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





13.13.6. Fotografia zyrtare e lojtarit, me prapavijë të bartë dhe fanellë të ekipit, në formatin e kërkuar për regjistrim në platformat elektronike të FBK-së dhe transmetuesve televizivë; dhe

13.13.7. Vërtetimi i kryerjes së pagesës sipas nenit 13.14 më poshtë.

13.14. Për regjistrimin e lojtarëve të huaj në garat e organizuara sipas këtyre Propozicioneve, ekipet kërkuese do të duhet të paguajnë shumat në vijim, në të cilat janë të përfshira edhe shpenzimet e pranimit të licencës përkatëse (LOC) nga FIBA:

13.14.1. Ekipet e Superligës së Meshkujve do të paguajnë shumën prej 500.00€ për secilin prej shtatë lojtarëve të parë të huaj të regjistruar me kalim nga klubi në klub apo kërkesë për LOC; shumën prej 5,000.00€ për lojtarin e tetë dhe të nëntë të huaj të regjistruar; shumën prej 10,000.00€ për lojtarin e dhjetë dhe të njëmbëdhjetë të huaj të regjistruar; dhe shumën prej 20,000.00€ për të gjithë lojtarët e huaj të regjistruar shtesë përtej kësaj shifre.

13.14.2. Ekipet e Superligës së Femrave do të paguajnë shumën prej 250.00€ për secilin prej pesë lojtareve të parë të huaj të regjistruar me kalim nga klubi në klub apo kërkesë për LOC; shumën prej 500.00€ për lojtaren e gjashtë dhe të shtatë të regjistruar; shumën prej 1,000.00€ për lojtaren e tetë dhe të nëntë të regjistruar; dhe shumën prej 3,000.00€ për të gjitha lojtarët shtesë të regjistruara përtej kësaj shifre.

13.15. Afati i fundit për regjistrimin e lojtarëve të huaj për ekipet e Superligës së Meshkujve është 72 orë para fillimit të xhiros së XXII të Superligës (para fillimit të pjesës së katërt), ndërsa për ekipet e Superligës së Femrave është 72 orë para fillimit të xhiros së XVI (para fillimit të pjesës së katërt) të kampionatit.

13.16. Rregulli sipas nenit 13.15 më sipër vlen edhe për regjistrimin e të gjithë lojtarëve të rinj të cilët nuk kanë kontrata për stinorin aktual apo të cilët kthehen për të garuar në Kosovë nga ligat e huaja.

13.17. Transferi i lojtarëve të huaj mes ekipeve të Kosovës është i mundshëm vetëm gjatë afatit kalimtar, nën kushte identike si lojtarët vendorë.

13.18. Në ligat e para të meshkujve dhe femrave, ekipet kanë të drejtë të regjistrojnë 1 (një) lojtar të huaj, nën kushtet e parapara për Superligën e Femrave. Afati i fundit për paraqitjen e lojtarëve të huaj është 72 orë para fillimit të xhiros së ciklit të fundit garues të stinorit aktual.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 14 - LOJTARËT-ET, PAJISJA

14.1. Ekipi vendës apo ekipi i parë i shënuar në protokoll të ndeshjes është i obliguar që në ndeshje të paraqitet me uniforma me ngjyrë të ndritshme, kurse ekipi mik apo ekipi i dytë i shënuar në protokoll të ndeshjes me ngjyrë të mbylltë, dhe e kundërta nëse ekipet paraprakisht kanë arritur marrëveshje me shkrim. Ekipi mysafir obligohet të respektojë ngjyrat e uniformës së ekipit vendas, nëse ato janë paraqitur zyrtarisht në FBK.

14.2. Gjatë prezantimit të ekipit të gjithë lojtarët duhet të jenë të veshur njëjtë.

14.3. Kapiteni i ekipit duhet të jetë dukshëm i shënuar në fanellë.

14.4. Fanellat e të gjithë lojtarëve duhet të jenë të vendosura në brekë gjatë tërë ndeshjes, lojtarët mund të paraqiten me numër nga 0 deri në 99 dhe nga 1 deri në 99.

14.5. Veshja e maicave nën fanella të cilat duken nuk është e lejuar.

14.6. Nuk është i lejuar reklamimi i pijeve alkoolike (përveç verës dhe birrës), cigareve (duhanit) dhe substancave të cilat gjinden në listën e ndaluar të substancave nga agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare të anti-dopingut.

14.7. Reklama e vendosur në fanellë në asnjë moment nuk guxon të mbulojë numrin apo mbiemrin e lojtarit.

14.8. Ekipet janë të obliguara që në fanellat e lojtarëve të vendosin logon - emblemën e FBK-së, në formatin e dhënë paraprakisht nga kjo e fundit. Emblema duhet të vendoset në anën e majtë të epërme të fanellës dhe dimensionet e saj nuk guxojnë të jenë më të vogla se 8 cm x 5 cm.

14.9. Ekipet janë të obliguara që në pjesën e pasme (në mes) të fanellave të lojtarëve të vendosin flamurin e Republikës së Kosovës.

14.10. Ekipet garuese janë të obliguara të vendosin edhe logon e ligës në të cilën garojnë, e cila miratohet nga Bordi i FBK me vendim dhe u dorëzohet të gjitha ekipeve pjesëmarrëse para fillimit të stinorit. Kjo logo do të vendoset nën emblemën e FBK-së dhe do të jetë e dimensioneve 8cm x 5cm.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 15 - TRAJNERËT

15.1. Detyrën e trajnerit apo ndihmës trajnerit mund ta ushtrojë vetëm personi i cili posedon licencën e trajnerit të lëshuar nga Shoqata e Trajnerëve e Kosovës (SHTBK). Nëse ekipi nuk ka trajner apo ndihmës trajner i cili i plotëson kushtet e lartë-cekura, detyrën e trajnerit do ta ushtrojë kapiteni i ekipit. Në këtë rast një prej përfaqësuesve zyrtar të ekipit (përfaqësuesi zyrtar, udhëheqësi teknik, mjeku etj.) nuk mund ta ushtrojë detyrën e trajnerit (të qëndrojë në këmbë gjatë ndeshjes, të kërkojë time-out, zëvendësim etj.).

15.2. Vetëm trajnerit dhe ndihmës trajnerit (por në asnjë rrethanë të dyve në të njëjtën kohë) i lejohe të qëndrojë në këmbë dhe të komunikojë me lojtarë gjatë ndeshjes, me kusht që të qëndrojë në hapësirën e kufizuar rreth bankinës së ekipit. Ndihmës trajneri në asnjë situatë edhe pse qëndron në këmbë, nuk guxon t'i drejtohet personave zyrtarë të ndeshjes (vëzhguesit dhe gjyqtarëve).

15.3. Trajnerin, në rast të mungesës së ndihmës trajnerit, gjatë ndeshjes mund ta zëvendësojë kapiteni i ekipit, vetëm në rastet e parapara me Rregullat e lojës së Basketbollit.

15.4. Trajneri dhe ndihmës trajneri janë përfaqësuesit e vetëm të ekipit që mund të komunikojnë me gjyqtarët ndihmës. Gjatë ndeshjes, gjatë ndërprerjeve të lojës dhe ndaljes së orës së lojës, trajneri mund të ankohet në punën dhe objektivitetin e gjyqtarëve ndihmës tek vëzhguesi i ndeshjes, i cili vlerëson se a duhet të lajmërohen gjyqtarët e ndeshjes për këtë.

15.5. Trajneri apo ndihmës trajneri i përjashtuar, përfaqësuesi zyrtar apo cilido person nga fletëparaqitja e lojtarëve për ndeshje, duhet të largohet nga fusha e lojës dhe nëse është nevojë edhe t'i lëshojë palestrën.

15.6. Në rast të dënimit të shqiptuar me ndalesë të ushtrimit të detyrës së trajnerit apo ndihmës trajnerit të ekipit, i njëjti në ndeshjen e ardhshme mund të jetë prezent tek shikuesit, por jo në anën në të cilën gjendet banka e ekipit së tij me lojtarë rezervë.

15.7. Nëse në ndeshjen zyrtare miqësore vjen deri te sjellja jo sportive e trajnerit, lojtarit apo shikuesve dhe kjo paraqitet nga ana e personit zyrtar, të njëjtit mund të sanksionohen nga ana e organit të FBK-së me sanksionet të cilat janë në fuqi për ndeshjet kampionale dhe ato të Kupës.

15.8. Vetëm trajnerët të cilët kanë licencën e lëshuar nga FBK dhe janë anëtarë të SHTFBK-së kanë të drejtë të udhëheqin me ekipet në atë kategori të garave për të cilën

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



janë licencuar dhe kanë kryer obligimet ndaj SHTFBK-së ose FBK-së, ndërsa trajnerët që nuk kanë licenca zyrtare dhe trajnimin profesional nuk kanë të drejtë të udhëheqin me ekipet apo shkollat e basketbollit në garat zyrtare dhe ndeshjet që organizohen nën patronatin e FBK-së.

15.9. Për regjistrimin e trajnerëve të huaj ekipet pjesëmarrëse do të paguajnë taksat në vijim:

15.9.1. Licenca për trajnerin e parë të huaj të regjistruar gjatë stinorit do të kushtojë 500.00€ (pesëqind euro);

15.9.2. Licenca për trajnerin e dytë të huaj të regjistruar gjatë stinorit do të kushtojë 1.000.00€ (njëmijë euro);

15.10. Pagesat e mësipërme zbatohen edhe për ndihmës-trajnerët e huaj.

NENI 16 - PERSONAT ZYRTARË TË EKIPIT

16.1. Udhëheqësi teknik:

16.1.1. Udhëheqës teknik i ekipit duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

16.1.2. Komisioni i Garave i lëshon më së shumti 2 (dy) licenca para fillimit të edicionit për udhëheqës teknik.

16.2. Përfaqësuesi zyrtar:

16.2.1. Përfaqësuesi zyrtar i ekipit duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës. Është përgjegjës për organizimin e ndeshjes, para vëzhguesit të ndeshjes apo gjyqtarit të parë në emër të klubit i cili është organizator i ndeshjes.

16.2.2. Nëse ekipi nuk ka përfaqësues zyrtar apo i njëjti me arsye duhet ta lëshojë fushën, gjatë ndeshjes mund të jetë i zëvendësuar me Udhëheqësin Teknik.

16.2.3. Përfaqësuesit zyrtarë gjatë ndeshjes nuk kanë të drejtë të komunikojnë me vëzhguesin dhe gjyqtarët. Ata janë vetëm të autorizuar që të japin të dhëna për ndeshjen. Nëse ndodhë që përfaqësuesi zyrtar të shkojë te tavolina zyrtare, para, gjatë dhe pas ndeshjes për të nxitur tensione, do të sanksionohet sipas rregullave zyrtare të basketbollit dhe kundër tij do të iniciohet, nëse është nevoja, procedura disiplinore.

16.2.4. Përfaqësuesi zyrtar i ekipit është i obliguar që të bëjë paraqitjen e lojtarëve dhe përfaqësuesve zyrtarë në formularin e plotësuar dhe të vërtetuar me vulën e klubit, të cilin duhet t'ia dorëzojë vëzhguesit të ndeshjes më së voni 40 minuat para fillimit të ndeshjes së bashku me licencat e lojtarëve dhe përfaqësuesve zyrtarë të ekipit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





16.2.5. Para fillimit të edicionit garues Komisioni i Garave i lëshon më së shumti 7(shtatë) licenca për përfaqësues zyrtarë të çdo ekipe.

16.3. Mjeku i ekipit dhe mjeku kujdestar:

16.3.1. Ekipi vendas apo organizatori i ndeshjes është i obliguar që të sigurojë mjekun kujdestar, i cili ka në dispozicion mjetet për dhënien e ndihmës së parë.

16.3.2. Mjeku kujdestar duhet të ketë licencën e vërtetuar për edicionin garues nga Komisioni i Garave.

16.3.3. Para fillimit të ndeshjes, mjeku do t'i prezantohet ekipit mik dhe do ta njoftojë për vendin ku do të ndodhet gjatë zhvillimit të ndeshjes.

16.4. Fizioterapeuti: Para fillimi të edicionit garues, Komisioni i Garave lëshon licencat për fizioterapeutin e ekipit.

16.5. Veshja zyrtare: Trajneri dhe personat tjerë zyrtarë të ekipit (përveç mjekut dhe Fizioterapeutit dhe ekonomit), janë të obliguar që të jenë të veshur me veshje zyrtare (këmishë, xhaketë, këpucë, pantallona të gjata). Rreptësisht është e ndaluar që gjatë kohës së ndeshjes personat zyrtarë në bankinë të jenë me pantallona të shkurtër (përveç të fizioterapeutit) dhe me patofne, papuçe apo sandale.

16.6. Zyrtari për Siguri:

16.6.1. Ekipet e ligës së seniorëve-eve (Superliga e Meshkujve dhe e Femrave), para fillimit të edicionit garues duhet të informojnë Komisionin e Garave për emrin e personit i cili do të ushtron detyrën e Zyrtarit për Siguri në klub me të gjitha shënimet për vendosjen e kontaktit (telefoni dhe posta elektronike).

16.6.2. Detyrat e Zyrtarit për Siguri të Klubit janë:

- që të bëjë sigurinë gjatë arritjes së ekipit mik në vendin ku do të zhvillohet ndeshja, hyrja pa pengesë në palestër, qëndrimi dhe largimi nga salla dhe vendi i zhvillimit të ndeshjes të ekipit mik dhe personave zyrtarë të ndeshjes (vëzhguesit dhe gjyqtarëve);

- që të kontaktojë Policinë e Republikës së Kosovës për të qenë prezente në ndeshje, minimumi 45 minuta para fillimit të ndeshjes. Numri i policëve të pranishëm në ndeshje duhet të jetë konform numrit të shikuesve në palestër (sipas rregullave të PK-së);

- që të kontaktojë Sigurimin Privat për të qenë prezente në ndeshje, minimumi 45 minuta para fillimit të ndeshjes. Numri i personave të angazhuar si sigurim privat në ndeshje duhet të jetë konform numrit të shikuesve në palestër (sipas rregullave të PK-së);

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





- që të bashkëpunojë ngushtë me PK dhe me Sigurimin Privat në mënyrë që fusha e lojës të jetë vetëm për akterët e ndeshjes prej fillimit e deri në fund të ndeshjes.

16.6.3. Komisioni i Garave para fillimit të edicionit garues do të lëshojë licencën në emër të Zyrtarit për Siguri të Klubit.

16.7. Personi për kontakt me FBK-në: Çdo klub është i obliguar që të caktojë personin përgjegjës, i cili në emër të klubit do t'i ketë të gjitha autorizimet për kontakte zyrtare me FBK-në. Në informatë klubi është i obliguar që të cekë numrin e telefonit dhe postën elektronike të personit të caktuar.

NENI 17 - KUSHTET E LICENCIMIT TË PËRFAQËSUESIT ZYRTAR TË EKIPIT

17.1. Çdo ekip para fillimit të edicionit garues mund të kërkojë që t'i lëshohen licencat për personat zyrtarë për çdo detyrë (funksion) veç e veç.

17.2. Kërkesa paraqitet me shkrim e bashkangjitur me një fotografi për çdo person për të cilin klubi aplikon.

17.3. Komisioni i Garave mund të refuzojë kërkesën e ekipit për lëshimin e licencës për personin e caktuar, nëse vlerëson se sjellja e tij në edicionin e kaluar garues nuk ka qenë në nivelin e nevojshëm sportiv.

17.4. Komisioni i Garave mund të vendos që të tërheqë licencën e lëshuar, nëse vlerëson se për një gjë të tillë janë krijuar rrethanat gjatë rrjedhjes së ndeshjes, kurse ekipi ka të drejtë që të propozojë ndonjë person tjetër.

NENI 18 - DHËNIA E DEKLARATAVE DHE KOMENTIMI I NDARJES SË DREJTËSISË

18.1. Pas përfundimit të ndeshjes së Superligës trajneri/ndihmës-trajneri/kapiteni i ekipit, janë të obliguar të ndajnë deklaratën për platformën televizive e cila i gëzon të drejtat audiot televizive për transmetimin e ndeshjeve të FBK-së.

18.2. Lojtarët, trajnerët, ndihmës trajnerët, personat zyrtarë, si dhe përfaqësuesit tjerë të ekipit, nuk kanë të drejtë të japin deklaratat publike për ndarjen e drejtësisë nga ana e

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

gjyqtarëve, të komentojnë publikisht ndarjen e drejtësisë si dhe të japin deklaratë të tjera jo-korrekte dhe jo sportive më cilat dëmtohet imazhi i ekipit kundërshtar, ligës dhe FBK-së.

18.3. Ankesat të cilat i përkasin ndarjes së drejtësisë, lëshimet në organizimin e ndeshjes dhe vërejtjet tjera i dorëzohen vëzhguesit të ndeshjes më së largu 15 minuta (vetëm nëse janë të nënshkruara nga kapiteni i ekipit) pas ndeshjes dhe dorëzohen në afat prej 24 orëve Komisionit të Garave, sipas dispozitave të këtyre Propozicioneve.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





ORGANIZIMI PARA FILLIMIT TË NDESHJES

NENI 19 - ORGANIZIMI I NDESHJES

19.1. Federata e Basketbollit të Kosovës është e liruar nga çdo përgjegjësi për organizimin e ndeshjeve kampionale.

19.2. Ndeshja nuk mund të fillojë në mungesë të kushteve elementare për zhvillimin e ndeshjes, siç janë prania e Policisë dhe sigurimit privat në nivel të duhur, temperatura jo e duhur në palestër dhe kushtet tjera bazike sipas këtyre Propozicioneve dhe rregullave të basketbollit.

19.3. Nëse nuk ka kushte për zhvillim të ndeshjes 45 minuta para fillimit të planifikuar të saj, skuadra mysafire nuk del në terren dhe ndeshja shtyhet për 24 orë. Në rast të mospajimit të kushteve elementare për zhvillim të ndeshjes dhe shtyrjes së saj sipas këtij paragrafi, ekipi vendas do të paguajë në xhirologarinë e FBK-së shumat e përcaktuara në këtë paragraf me qëllim të mbulimit të shpenzimeve të shkaktuara për skuadrën mysafire, personat zyrtarë dhe ekipet e xhirit televiziv. Paga sipas këtij paragrafi duhet të bëhet jo më vonë se 3 orë para terminit të paraparë për zhvillimin e ndeshjes së shtyrë, në të kundërtën ekipi vendas do të konsiderohet se ka dështuar në sigurimin e kushteve elementare për ndeshje dhe do ta humbë ndeshjen me rezultat zyrtar, në pajtim me rregullat e basketbollit. Shumat që duhet paguar nga ekipet vendase që kanë dështuar në sigurimin e kushteve elementare për zhvillim të ndeshjes janë:

19.3.1. Për skuadrat e Superligës së Kosovës, shuma që duhet paguar është 3.000.00€ (tremijë euro);

19.3.2. Për skuadrat e Superligës së Femrave dhe Ligës së Parë të Meshkujve, shuma që duhet paguar është 1.000.00€;

19.3.3. Për skuadrat tjera që garojnë sipas këtyre Propozicioneve, shuma që duhet paguar është 500.00€.

19.4. Ekipi vendas në cilësinë e organizatorit është i obliguar që t'i ndihmojë ekipit mik në çdo rast, t'ia caktojë përfaqësuesin e ekipit që t'i ndihmojë dhe të jep informata të nevojshme për ndeshje.

19.5. Organizatori duhet me kohë të paraqesë ndeshjen tek Policia e Kosovës dhe në ndeshje duhet të jetë prezent numër i mjaftueshëm i forcave policore, varësisht nga numri i shikuesve dhe niveli i rrezikshmërisë së ndeshjes. Nëse ndeshja nuk është paraqitur tek PK (apo ka mungesë të PK) e njëjta duhet të zhvillohet brenda 24 orëve dhe të gjitha

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





shpenzimet tjera i bartë organizatori, krahas pagesës së taksës sipas nenit 19.3. më sipër. Kërkesa e paraqitur në PK për policinë sekondare duhet ti paraqitet Vëzhguesit të ndeshjes.

19.6. Organizatori duhet të sigurojë 2 qasje të hyrjes-daljes të lojtarëve për në teshatore, nëse jo atëherë skuadra mysafire do të largohet e para dhe atë para largimit të skuadrës vendase dhe gjyqtarëve.

19.7. Organizatori duhet të sigurojë nga 10 vende për anëtarët e kryesisë dhe atë në anën tjetër të bankinës 3 metra larg vijës fundore.

19.8. Organizatori duhet të sigurojë vend të përshtatshëm për vendosjen e Reklamave fikse dhe LED të sponsoruesve të ligës dhe të FBK-së në sallë, sipas përcaktimit dhe formatit të nominuar nga FBK para fillimit të stinorit. Vendosja e reklamave bëhet sipas kontratave që FBK-ja ka me sponsorët e saj. Organizatori i mban përgjegjësitë dhe i nënshtrohet sanksioneve për mos respektimin e dispozitave të marrëveshjes me sponsorë. Vendosja e reklamave të sponsorit gjeneral të FBK-së do të përcaktohet në një Rregullore për Marketing në ndeshjet e organizuara nga FBK, e cila do të miratohet nga Bordi i FBK-së dhe do të konsiderohet pjesë përbërëse e këtyre Propozicioneve të Garave.

19.9. Organizatori është i obliguar që në çdo ndeshje të vendos flamurin shtetëror me dimensione 200 x 96cm në vendin e dukshëm për të gjithë pjesëmarrësit.

19.10. Organizatori është i obliguar që të sigurojë hapësirën e veçantë për përfaqësuesit e akredituar të mediave.

19.11. Organizatori është i obliguar që të sigurojë hapësirën e veçantë, tavolinat punuese për radio dhe TV kanalet të cilat transmetojnë ndeshjet e organizuara sipas këtyre Propozicioneve.

19.12. Organizatori është i obliguar që 90 minuta para fillimit të ndeshjes të kontaktojë produksionin në lidhje me transmetimin e drejtpërdrejtë të ndeshjes për të gjitha ndeshjet të cilat ekziston transmetimi televiziv, si dhe të kontaktojë me personat përgjegjës të FBK-së për të gjitha ndeshjet në të cilat organizohet shfaqja online në platformat e FBK-së.

19.13. Organizatori është i obliguar që të sigurojë personin me pajisje për pastrimin e fushës së lojës, i cili në çdo kohë duhet të jetë afër fushës (prapa panove të reklamave) dhe të veprojë menjëherë në ftesë të gjyqtarëve. Personi përgjegjës sipas këtij paragrafi duhet të jetë lojtar i regjistruar i grupmohave të reja i ekipit organizator i licencuar për garim në FBK.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





19.14. FBK ruan të drejtën e realizimit të marketingut për sponsorët dhe partnerët në fusha të lojës dhe në palestrat ku zhvillohen ndeshjet. Dispozitat e sakta të marketingut precizohen me Udhëzuesin për Marketing, që e miraton Bordi i FBK-së para fillimit të çdo sezoni. Shkeljet e rregullores së marketingut do të konsiderohen shkelje të këtyre Propozicioneve dhe do të sanksionohen sipas tyre.

19.15. Ekipi organizator është përgjegjës për sjelljet e shikuesve dhe të ftuarve të vendosur pranë terrenit dhe do të marrë të gjitha masat për të siguruar që të njëjtit me sjelljet e tyre nuk do të pengojnë akterët në terren. Në të kundërtën, vëzhguesi dhe/ose gjyqtari i parë i ndeshjes ruan të drejtën e largimit të cilitdo person që pengon në çfarëdo forme, me veprime, lëvizje, sharje/fyerje/kërcënim, apo në çfarëdo mënyre tjetër, akterët e ndeshjes (lojtarët, zëvendësuesit, personat zyrtarë, etj.).

NENI 20 - PALESTRA

20.1. Ndeshjet në të gjitha nivelet, mund të zhvillohen vetëm në Palestra të cilat i plotësojnë kushtet e parapara me rregullat zyrtare të basketbollit dhe FIBA Equipment të cilat janë të regjistruara nga ana e Komisionit të Garave.

20.2. Çdo palestër duhet të ketë hyrje zyrtare, të ndarë nga hyrja e shikuesve, e cila mundëson hyrje/dalje të papenguar të ekipeve dhe personave zyrtarë.

20.3. Nëse vërtetohet se salla nuk i plotëson kushtet e parapara me akte normative dhe me këto Propozicione, Komisioni i Garave do të caktojë një afat kohor brenda të cilit duhet të mënjanohen të gjitha mungesat, në të kundërtën, do të ndalohet zhvillimi i ndeshjeve në atë palestër.

20.4. Organizatori duhet të ketë pajisjet e mjaftueshme teknike dhe staf profesional për ndërrimin e tabelës në kohën më të shkurtër nëse vjen deri te dëmtimi i tabelës si dhe të gjitha pajisjeve tjera të nevojshme për zhvillimin e garave sipas këtyre Propozicioneve dhe rregullave të lojës.

20.5. Organizatori duhet të ketë pajisjet për matjen e lartësisë së harkut, temperaturës në palestër dhe të gjitha pajisjet tjera të nevojshme për zhvillimin e grave sipas këtyre Propozicioneve dhe rregullave të lojës.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 21 - LOKALET ZYRTARE

- 21.1.** Organizatori është i obliguar që të sigurojë lokalet zyrtare në palestër:
- 21.1.1.** Teshatoren për ekipin mik me minimum 24 varëse për robe, 12 ulëse apo bankinë për 12 persona;
 - 21.1.2.** Teshatoren për gjyqtarë me minimum 6 varëse për robe, tri ulëse dhe tavolinën;
 - 21.1.3.** Lokalin për përpilimin e raportit të vëzhguesit (me kompjuter dhe internet);
 - 21.1.4.** Dhomën e përshtatshme për kontrollë të dopingut me një tualet.
- 21.2.** Teshatoret për lojtarë dhe gjyqtarë duhet të jenë të pajisura me nyje sanitare, më tusha dhe me hapësirë të nevojshme për zhveshjen e 12 lojtarëve.
- 21.3.** Në teshatoret për lojtarë dhe gjyqtarë, organizatori është i obliguar të sigurojë pije të mjaftueshme freskuese (ujë).

NENI 22 - FUSHA E LOJËS

- 22.1.** Dyshemeja për lojë duhet të jetë nga parketi apo bazamenti tjetër i cili i plotëson standardet e FIBA-s.
- 22.2.** Fusha e lojës duhet të jetë me dimensione 28x15 metra, sipas rregullave zyrtare të lojës me hapësirë prej 2m rreth fushës së lojës në të cilën nuk guxon të ketë reklama apo diç tjetër.
- 22.3.** Fusha duhet të jetë e shënuar në pajtim me Rregullat e lojës së basketbollit. Të gjitha vijat e parapara me rregulla duhet të jenë të shënuara me ngjyrë të njëjtë - e BARDHË, e rekomanduar nga FIBA.
- 22.4.** Fusha e lojës duhet të jetë e ndriçuar njëjtë në çdo pjesë të saj me më së paku 1.500 lukse, e matur 1 (një) metër mbi sipërfaqen e fushës së lojës.
- 22.5.** Lartësia e pikës më të ulët e tavanit - plafonit, gjegjësisht pengesa më e ulët mbi fushë të lojës duhet të jetë 7 (shtatë) metra e matur nga dyshemeja (parketi) e fushës.
- 22.6.** Në fushën e lojës nuk lejohet vendosja e LOGOVE të sponsoreve në hapësirën ku mund të ketë Pozicionim të lojtarit brenda/jashtë zonës së gjysmërrethit pa ndërhyrje.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 23 - BANKINAT PËR EKIPE

23.1. Bankinat për ekipe duhet të jenë mjaft të gjata që në mënyrë komode të ulen 16 persona, apo në vendin e rezervuar për bankinën e ekipit të ketë 16 karrige.

23.2. Në bankinën për lojtarë rezervë kanë të drejtë, kurse gjatë ndeshjes duhet të ulen, këta persona të cilët janë paraqitur në listën paraqitëse të ekipit dhe posedojnë licencat e vlefshme për sezonin garues:

23.2.1. Trajneri, i cili ka të drejtë të qëndrojë edhe gjatë ndeshjes në hapësirën e kufizuar dhe që i takon ekipit të tij;

23.2.2. Trajneri ndihmës, i cili ka të drejtë të qëndrojë gjatë ndeshjes në hapësirën e kufizuar dhe i takon ekipit të tij, ka të drejtë komunikimi vetëm me lojtarët e tij, nëse në atë moment trajneri është i ulur (nuk është e lejuar të qëndrojnë të dytë në të njëjtën kohë);

23.2.3. Udhëheqësi teknik;

23.2.4. Përfaqësuesi zyrtar i ekipit;

23.2.5. Shtatë lojtarë rezervë;

23.2.6. Mjeku;

23.2.7. Fizioterapeuti.

23.3. Ekipi gjatë ndeshjes në bankinë mund të ketë edhe 2 fizioterapeutë, 2 mjekë apo 2 ndihmës trajnerë, por numri i personave zyrtarë jashtë lojtarëve rezervë nuk mund të jetë më i madh se 9 (nëntë).

23.4. Në bankina të ekipit ndalohet ulja e personave që janë bartës të posteve më të larta ekzekutive në klubet përkatëse.

23.5. Trajneri, ndihmës trajneri apo personi zyrtar i ekipit nuk ka të drejtë që të jetë në bankinën e ekipit nëse nuk posedon licencën për edicionin garues, të vërtetuar dhe të lëshuar nga Shoqata e Trajnerëve dhe Komisioni i Garave.

23.6. Bankina e ekipit mik duhet të jetë e siguruar me mburojë nga pleksi glasi në tërë gjatësinë e bankinës.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 24 - TAVOLINA ZYRTARE

24.1. Tavolina zyrtare dhe tavolina teknike duhet të jetë e vendosur në mesin e një prej vijave të mesme të fushës (prapa së cilës gjinden bankinat e lojtarëve rezervë të dy ekipeve).

24.2. Gjatësia e tavolinës zyrtare duhet të ketë më së paku 4 metra në mënyrë që të ofrojë kushte për punën e personave zyrtarë që janë të ulur dhe atë nga ana e majtë në të djathtë:

24.2.1. Matësi i 14 dhe 24 sekondave;

24.2.2. Matësi i kohës;

24.2.3. Vëzhguesi i ndeshjes;

24.2.4. Procesmbajtësi i protokollit Digjital (DSS) të ndeshjes;

24.3. Tavolina teknike do të ofrojë kushte për punë të:

24.3.1. Mbajtësi i statistika live;

24.3.2. Komentatori i ndeshjes;

24.3.3. Speakeri zyrtar;

24.3.4. Cilido person i autorizuar nga FBK për këtë qëllim.

24.4. Në të dy anët e tavolinës zyrtare duhet të jenë të vendosura nga dy karrige për lojtarët (zëvendësuesit) që presin për të hyrë në lojë.

24.5. Organizatori është i obliguar që të sigurojë:

24.5.1. Treguesit prej numrit 1 - 5 për gabimet personale (vetjake);

24.5.2. Treguesit e gabimeve personale (Bonus);

24.5.3. Treguesin e shigjetës së zotërimit alternativ të topit;

24.5.4. Pipin rezervë, në rast defekti të sirenës në semafor apo dëgjimi i dobët i sirenës;

24.5.5. Metrin ose mjetin adekuat për matjen e lartësisë së koshit;

24.6. Më tej, Organizatori është i obliguar që të sigurojë edhe mjetet teknike ndihmëse për ndeshje (sipas nevojës):

24.6.1. Kronometrin e dorës për matjen e kohës me mundësi që kohën ta matë prapa dhe vazhdimi i matjes së kohës nga koha e ndalur;

24.6.2. Kronometrin për matjen e 24 sekondave;

24.6.3. Mjetin për të treguar 10 sekondat e fundit të aksionit të ekipit.

24.6.4. Treguesin e rezultatit (semafori Manual).

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 25 - SEMAFORI ELEKTRONIK

25.1. Semafori që do të shfrytëzohet për ndeshjet e organizuara sipas këtyre Propozicioneve duhet të përmbushë të gjitha kriteret sipas rregullave të lojës.

25.2. Në veçanti, përveç përmbushjes së kushteve sipas paragrafit të mësipërm, semafori elektronik duhet të ketë mundësi që të masë kohën e lojës prej 10:00 në 00:00 minuta e treguar me numra. Në minutën e fundit të periudhës apo të kohës shtesë, semafori të tregojë edhe të qindtat e sekondës.

25.3. Semafori duhet të tregojë rezultatin, kohën e mbetur dhe numrin e gabimeve personale (vetjake)/teknike të ekipeve, si dhe hyrjen në bonus.

25.4. Semafori duhet të jetë i vendosur në pjesë të dukshme, sipas rregullave të lojës.

NENI 26 - APARATURA PËR 24 SEKONDA

26.1. Aparaturat (display) për matjen e 24 sekondave duhet të jenë të vendosura mbi të dy tabelat e koshave.

26.2. Nëse nuk mund të vendosen mbi tabela, atëherë ato mund të vendosen në dy këndet e kundërta të fushës së lojës.

26.3. Pajisja për matje duhet të ketë mundësinë e rikthimit të kohës së lojës, kohës së plotë të sulmit (24 sec) apo kohës së sulmit në rast të vazhdimit nga gjysmë-pjesa e kundërshtarit (14 sec), dhe në 5 sekondat e fundit të sulmit të tregohen edhe qindrat e sekondave.

NENI 27 - TOPI I LOJËS

27.1. Ndeshjet e Superligës së Kosovës në basketboll zhvillohen me topa 'SPALDING'-TF1000 me Emblemë të FBK-së apo Superligës.

27.2. Ndeshjet e Superligës së Femrave dhe Ligës së Parë të Femrave zhvillohen me topa 'SPALDING'- WNBA.

27.3. Ndeshjet e ligave tjera të meshkujve zhvillohen me topa 'SPALDING'-TF1000.

27.4. Organizatori i ndeshjes është i obliguar që të sigurojë së paku katër topa në gjendje të rregullt për skuadrën mysafire më së voni 30 minuta para fillimit të ndeshjes. Gjyqtarit të

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Parë i dorëzohen topat për zhvillimin e ndeshjes, dhe Gjyqtari i Parë vendos për zgjedhjen e topit të lojës.

NENI 28 - TEMPERATURA NË PALESTRA

28.1. Temperatura gjatë zhvillimit të ndeshjes në sallë nuk mund të jetë më pak se minimum 15 Gradë Celsius. Në rast të dështimit të ekipit vendas për të siguruar palestrën që përmbushë këtë kusht, do të zbatohen dispozitat e nenit 19.3 të këtyre Propozicioneve.

28.2. Ekipi vendas – organizatori, është i obliguar që vëzhguesit të ndeshjes t'i sigurojë termometrin për çdo ndeshje, nëse është e nevojshme që të bëhet matja e temperaturës në sallë.

28.3. Në rast se ekipi nikoqir nuk ka mundësi të sigurojë palestër të përshtatshme për zhvillimin e garave sipas këtij neni, Komisioni i Garave do të vendosë për zhvendosjen e ndeshjeve të ekipit në fjalë si vendas.

NENI 29 - ZËRIMI

29.1. Skuadrat vendase ose organizatorët e ndeshjeve të Superligave janë të obliguar të sigurojnë pajisjet e zërimit të cilat përdoren para fillimit dhe gjatë zhvillimit të ndeshjes, për prezantimin zyrtar të lojtarëve dhe për dhënien e informatave të tjera të ndeshjes si dhe intonimin e himnit të Republikës së Kosovës.

29.2. Zërimi nuk guxon të përdoret për lëshimin e muzikës gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes derisa ora për matjen e kohës së ndeshjes është duke punuar, për të nxitur shikuesit për anim, komentimin e ndarjes së drejtësisë etj.

29.3. Zërimi nuk guxon të përdoret për lëshimin e muzikës ose përdorimin e mikrofonit me qëllim nxitjen e ofendimeve në kor para dhe gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes.

29.4. Personi i cili manovron me zërim dhe moderatori zyrtar, duhet të jenë në tavolinën teknike, afër tavolinës zyrtare dhe gjatë kohës së ndeshjes duhet të bashkëpunojë me Vëzhguesin e ndeshjes.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



NENI 30 - REZERVIMET E BILETAVE DHE FTESAVE PËR EKIPIN MYSAFIR DHE ZYRTARËT DHE TË FTUARIT E FBK

30.1. Organizatori është i obliguar që për ekipin mysafir të sigurojë deri 10 ftesa të cilat do t'i dorëzohen 48 orë para fillimit të ndeshjes apo me arritjen e ekipit në vendin e zhvillimit të ndeshjes.

30.2. Organizatori është i obliguar që në kërkesë me shkrim të ekipit mysafir dhe pas dhënies së pëlqimit me shkrim nga Komisioni i Garave 72 orë para fillimit të ndeshjes, të sigurojë deri në 300 bileta për shikuesit e saj. Komisioni i Garave mund të jap pëlqimin e tij ose jo, pas konsultimit me organet e sigurisë. Parashtruesi i kërkesës e mban përgjegjësinë për shikuesit e vet dhe i nënshtrohen sanksioneve sikurse edhe vendësi për mos respektimin e Propozicioneve të Garave.

30.3. Organizatori është i obliguar që për të gjitha ndeshjet të sigurojë automatikisht 5 ulëse për zyrtarët e FBK-së, gjegjësisht për Kryetarin, Sekretarin e Përgjithshëm dhe anëtarët tjerë të Komitetit Ekzekutiv. Për më shumë, organizatori është i obliguar që në kërkesë me shkrim të FBK-së, të sigurojë 10 ulëse të tjera në hapësirën e caktuar për VIP për anëtarët e Bordit, mysafirët dhe Sponsoruesit e Ligave të FBK. Kryetari të FBK-së i takon ulësja qendrore në vendin qendror të caktuar për VIP. Bartësit e postit më të lartë ekzekutiv në klubet përkatëse, nëse janë të pranishëm në sallë, preferohet të përcjellin ndeshjen në shoqëri të Kryetarit të FBK-së.

30.4. Organizatori i ndeshjes është i obliguar të sigurojë që fusha e lojës t'i takojë vetëm akterëve të ndeshjes që janë të paraqitur në listat paraqitëse të klubeve, dhe zyrtarëve të ndeshjes.

30.5. Cenimi i fushës nga ana e shikuesve, personave jo zyrtarë dhe i cili mund të vijë deri te kontakti fizik me lojtarët, trajnerët dhe personat zyrtarë është i papranueshëm dhe do të sanksionohet konform këtyre Propozicioneve. Organizatori i ndeshjes duhet të sigurohet që prej fillimit të ndeshjes e deri pas përfundimit të saj përveç akterëve të ndeshjes askush të mos jetë i pranishëm në fushën e lojës.

30.6. Në parket lejohet vendosja e maksimum 300 karrigeve/ulëseve për VIP.

30.6.1. 10 ulëse për skuadrën mysafire dhe 10 për skuadrën vendase dhe atë vetëm në pjesën e pasme të koshave, 3 metra larg vijës fundore në anën tjetër të bankinës.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



30.6.2. Në pjesën tjetër (pjesën qendrore dhe pjesa e mbetur pas koshave) mund të ulen vetëm bartësit e akreditimeve apo biletave/ftesave VIP (ku përfshihen ulëset e rezervuara për FBK).

30.6.3. Mysafirët e ulëseve në parket kanë qasje/hyrje në sallë të ndryshme nga ajo për publikun.

30.6.4. Organizatori duhet të sigurojë që numri i personave në parket të mos kalojë numrin e ulëseve, në mënyrë që të gjithë shikuesit në pjesën e parketit të jenë të ulur (personat pa ulëse nuk mund të lejohen qasje në parket).

30.7. Nëse konstatohet se ka me tepër karrige të vendosura ato duhet të largohen dhe nëse ato nuk largohen ndeshja nuk do të fillojë. Njësoj, nëse konstatohet se ka më shumë persona se karrige, ata persona duhet larguar nga parketi (qëndrimi në këmbë nuk lejohet). Përgjegjësia për numërimin e karrigeve - ulëseve në dysheme - parket i takon vëzhguesit të ndeshjes.

NENI 31 - OBLIGIMET E EKIPIT MYSAFIR

31.1. Ekipi mysafir është i obliguar të mbërrijë me kohë në vendin e zhvillimit të ndeshjes duke përdorë transportin vetanak.

31.2. Ekipi mysafir duhet me shkrim ta njoftojë Zyrtarin për Siguri të ekipit vendës, më së voni 48 orë para fillimit të ndeshjes, duke e cekur terminin dhe vendin e saktë ku do të mbërrijnë në vendin ku zhvillohet ndeshja.

31.3. Nëse ekipi mysafir nuk e lajmëron Zyrtarin për Siguri të ekipit vendës apo arrin në termin tjetër nga ai që është caktuar, organizatori nuk do të ketë përgjegjësi për pasojat eventuale.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





ORGANIZIMI GJATË KOHËS SË NDESHJES

NENI 32 - FILLIMI I NDESHJES

32.1. Për fillim të ndeshjes konsiderohet momenti kur gjyqtarët hyjnë në fushë dhe kërkojnë nga kohë matësi që të lëshojë në funksion orën e ndeshjes që të punojë nga 20:00 në 00:00 minuta.

32.2. Me fillimin e këtyre 20 minutave, vëzhguesi verifikon se organizatori i ka plotësuar të gjitha kushtet dhe dispozitat e rregullave dhe të këtyre PG.

32.3. Nëse konstatohet ndonjë mungesë/defekt në ndonjë pajisje apo mos prezencë e gjyqtarit-ëve ndihmës, organizatorit do t'i lejohen jo më shumë se 30 minuta që t'i sjellë në rregull pajisjet apo që të sigurojë gjyqtarin-ët ndihmës.

32.4. Nëse mungesat e konstatuara nuk mund të eliminohen në kohën e caktuar, apo nëse të njëjtat janë shkaktuar pas lëshimit në punë të orës 20:00 minuta para fillimit të ndeshjes, ndeshja do të shtyhet brenda 24 orëve të ardhshme sipas këtyre Propozicioneve.

32.5. Ndeshja mund të zhvillohet apo edhe të përfundohet me mjetet ndihmëse teknike të cekura në nenin 25, por me kusht që Gjyqtari i Parë dhe ekipi mik të pajtohen që ndeshja të zhvillohet nën këto kushte, gjë që duhet të konstatohet dhe të ceket në Raportin e Vëzhguesit dhe të verifikohet me nënshkrimin e përfaqësuesit zyrtar të ekipit mik.

32.6. Fillimi i ndeshjes sipas minutave:

40:00 minuta para fillimit të ndeshjes

Matësi i kohës, me lejin e vëzhguesit, e lëshon në punë orën për matjen e Kohës; Përfaqësuesit zyrtarë i sjellin vëzhguesit të ndeshjes fletëparaqitjet e lojtarëve dhe personave, si dhe licencat e tyre;

20:00 minuta para fillimit të ndeshjes (intervali i ndeshjes)

Gjyqtarët hyjnë në fushë, përshëndeten me përfaqësuesit zyrtarë dhe vendosen përballë tavolinës zyrtare.

10:00 minuta para fillimit të ndeshjes

Trajnerët në ftesë të vëzhguesit të ndeshjes (gjyqtarit të parë), me nënshkrimin e tyre, vërtetojnë lojtarët e paraqitur të ekipit dhe caktojnë pesëshen e cila do të fillojë

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





ndeshjen. Gjatë kësaj procedure, protokollin e ndeshjes i pari e nënshkruan trajneri i ekipit vendas apo trajneri i ekipit që është shënuar i pari në protokollin e ndeshjes.

09:00 minuta para fillimit të ndeshjes

Gjyqtari i parë i fton lojtarët që ta braktisin fushën dhe të vendosen te bankina e tyre për t'u bërë prezantimi i lojtarëve me anë të zërimit;

Së pari prezantimi bëhet i ekipit mik apo ekipit të dytë të shënuar në protokollin e ndeshjes duke filluar nga kapiteni i ekipit, lojtarëve në bazë të numrave në fanellë dhe në fund të trajnerit dhe ndihmës trajnerit. Lojtarët radhitën përgjatë vijës për gjuajtjet e lira.

Pas prezantimit të ekipeve, prezantuesi i prezanton edhe personat zyrtarë (gjyqtarët dhe vëzhguesin) të ndeshjes. Pas përfundimit të prezantimit të pjesëmarrësve, ekipet përshëndeten në mes veti.

06:00 Intonimi i himnit të Republikës së Kosovës

03:00 minuta para fillimit të ndeshjes

Koha e mbetur për nxehjen e ekipeve. Kohëmatësi i njofton gjyqtarët.

01:30 minuta para fillimit të ndeshjes

Gjyqtari i parë i njofton ekipet që të tërhiqen nga fusha dhe të përgatiten pesëshet për fillimin e ndeshjes.

30 sekonda para fillimit të ndeshjes

Kohëmatësi e reseton orën në 10:00 minuta për fillimin e ndeshjes. Pesëshet e caktuara hyjnë në fushën e lojës.

Pas përfundimit të ndeshjes të gjithë lojtarët dalin në fushë, përshëndeten në mes veti dhe kthehen në bankinat e tyre.

NENI 33 - RRJEDHA E NDESHJES

33.1. Organizatori i mban të gjitha përgjegjësitë për të gjitha shkeljet dhe incidentet të cilat ndodhin para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes.

33.2. Organizatori duhet të jetë i gatshëm në çdo moment që të kontrollojë sjelljen e shikuesve.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





33.3. Organizatori nuk guxon të lejojë personat jo zyrtarë dhe shikuesit që të cenojnë fushën e lojës në pjesën e rrethuar apo të valëvitin me flamuj përtej pjesës së rrethuar.

33.4. Organizatori është përgjegjës për hedhjen e petardëve dhe gjësendeve tjera në fushë nga ana e shikuesve, pa marrë parasysh se cila anë e shikuesve bënë hedhjen e tyre.

33.5. Në rast të tollovide në fushë apo sallë, organizatori duhet të ndërmarrë masa dhe të mbrojë të gjithë anëtarët e ekipeve, gjyqtarët dhe vëzhguesin. Organizatori duhet të sigurojë hyrjen e tyre në teshatore, kurse për ekipin mik dhe personat zyrtarë edhe largimin nga qyteti. Nëse incidentet ndodhin nga ana e shikuesve të ekipit mik, të lajmëruar në mënyrë zyrtare, përgjegjës do të jetë ekipi mik. Gjatë ndeshjes personi zyrtar i ekipit vendas duhet të jetë i ulur në bankën e rezervistëve dhe për organizimin e ndeshjes përgjegjës është vëzhguesi i ndeshjes.

33.6. Për të gjitha lëshimet sipas këtij neni si dhe tentim sulmet apo sulmet fizike në ekipe, gjyqtarë apo vëzhgues do të caktohen dënimet e përcaktuara sipas këtyre Propozicioneve.

NENI 34 - GRUPET SIMPATIZUESE, MASKOTA

34.1. Është e ndaluar hyrja në sallë për personat të cilët kanë me veti pije alkoolike, armë apo gjësende të cilat mund të shfrytëzohen si armë, duke përfshirë edhe pishtarë, petardë dhe mjete të tjera piroteknike. Nëse këto mjete lajmërohen gjatë ndeshjes, organizatori është i obliguar që mjetet e tilla dhe personat menjëherë t'i largojë nga salla.

34.2. Është e ndaluar futja e flamujve, simboleve ose teksteve të cilat, me apo pa qëllim, fyejnë në baza fetare, nacionale dhe racore, ndikojnë ose bëjnë thirrje në dhunë, si dhe pamfleteve të cilat kanë përmbajtje josportive dhe tallje me ndonjë individ, ekip apo organizatë. Është obligim i klubit që menjëherë t'i largojë, në të kundërtën ndeshja nuk do të vazhdojë, kurse pasojat do t'i bartë organizatori në bazë të Propozicioneve të Garave dhe Ligjit për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive.

34.3. Organizatori mund të organizojë grupe të cilat gjatë ndërprerjeve të lojës (time out), në pushimet në mes të periudhave, dhe gjatë çdo ndërprerje të gjatë të lojës, me lejinim e gjyqtarëve, të ekzekutojnë pika artistike (paraqitje artistike apo muzikore).

34.4. Në fushë mund të jetë prezentë edhe maskota e ekipit, e cila mund të paraqitet vetëm gjatë ndërprerjeve të lojës.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

34.5. Gjatë kohë së lojës maskota apo grupi duhet të qëndrojë prapa panove të reklamave, jashtë hapësirës prej 2 metrave nga fusha e lojës.

NENI 35 - INSTRUMENTET MUZIKORE

35.1. Shikuesit e ndeshjes mund të përdorin instrumente muzikore, për të bërë atmosferë anuse, por nuk lejohet të qëndrojnë prapa bankinave të ekipeve.

35.2. Nuk lejohet përdorimi i sirenavë, vuvuzelave dhe rekuizitave të ngjashme të cilat bëjnë zhurmë të madhe.

35.3. Nuk lejohet përdorimi i mjeteve që në çfarëdo mënyre (audio-vizuale, fizike, etj.) pengojnë akterët e ndeshjes.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





ORGANIZIMI - PAS PËRFUNDIMIT TË NDESHJES

NENI 36 - STATISTIKA E NDESHJES

- 36.1.** Organizatori është i obliguar që t'i udhëheqë statistikat e ndeshjes për ndeshjet e Superligës së Kosovës, Ligës së Parë të Meshkujve dhe Superligës së Femrave.
- 36.2.** Mbajtësi i statistikave është i obliguar që t'i realizojë të gjitha punët për mbarëvajtjen e statistikave live dhe t'i dorëzojë ato elektronikisht në adresën e Komesarit të Garave.
- 36.3.** Statistikat mbahen live në ueb faqen e FBK-së dhe janë pronë e FBK-së. FBK ruan të drejtën e disponimit me statistikat në formën dhe mënyrën që i shërben më së miri basketbollit të Kosovës.
- 36.4.** Organizatori është i obliguar të sigurojë rrjetin kablove stabile të internetit për kompjuter në të cilën udhëhiqet statistika zyrtare, për transmetim direkt dhe për përcjelljen me kohë të statistikave të Komesarit të Garave.
- 36.5.** Në rast të kërkesës së shtabit teknik të ekipeve ose gazetarëve të akredituar, klubet janë të obliguara që t'ua japin nga një kopje të statistikave pas secilit çerek të ndeshjes. Për këtë qëllim, organizatori duhet të sigurojë qasje në një printer funksional gjatë organizimit të secilës ndeshje sipas këtyre Propozicioneve.
- 36.6.** Udhëheqësit e statistikave në ndeshje janë personat që licencohen nga FIBA ose FBK për mbajtje të statistikave.

NENI 37 - VIDEO XHIRIMI

- 37.1.** Ndeshjet e zhvilluara sipas këtyre Propozicioneve duhet të xhirohen në format të përshtatshëm për transmetim televiziv apo për shfaqje në platformat online të FBK-së. Xhirimet e prodhuara të ndeshjeve janë pronë e FBK-së.
- 37.2.** Xhirimi duhet të fillojë nga momenti i daljes së ekipeve në fushë dhe duhet të mbarojë pas largimit përfundimtar të gjyqtarëve nga fusha e lojës.
- 37.3.** Të gjitha ndeshjet e Superligës së Kosovës do të transmetohen në platforma me shtrirje mbarëkombëtare ndërsa ndeshjet tjera duhet të vihen në dispozicion nga organizatori për shfaqje në Youtube, përmes shfrytëzimit të sistemit të xhirimit autonom të vendosur nga FBK apo përmes organizimit të xhirimit të ndeshjes nëpërmjet operatorëve tjerë të angazhuar për këtë qëllim.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



NENI 38 - SHPALLJA E REZULTATIT PËRFUNDIMTAR TË NDESHJES

38.1. Vëzhguesi apo Gjyqtari i Parë (nëse në ndeshje nuk ka vëzhgues) më së voni 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes janë të obliguar që ta njoftojnë Komesarin e Garave me rezultatin e arritur nëpërmjet telefonit.

38.2. Nëse Komesari i Garave nuk njoftohet me rezultatin përfundimtar, apo nuk njoftohet në mënyrën e përcaktuar me nenin 38.1. vëzhguesi apo Gjyqtari i Parë (nëse nuk ka vëzhgues) do të dënohen në pajtim me kritereve të këtyre Propozicioneve.

NENI 39 - RAPORTI I VËZHGUESIT/PROTOKOLLI

39.1. Përpilimi i raportit të vëzhguesit të bëhet në kompjuterin e mbajtësit të statistikave brenda 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes, në rastet ku ekzistojnë kushtet për përpilimin e raportit të ndeshjes. Në rastet e tensioneve apo pamundësisë, raporti i ndeshjes mund të dërgohet në mundësinë e parë të përpilimit.

39.2. Në raportin e vet, vëzhguesi duhet të cek mënyrën e udhëtimit të personave zyrtarë në ndeshje, së bashku apo në mënyrë individuale.

39.3. Vëzhguesi dhe gjyqtarët nuk janë të autorizuar që ta njoftojnë opinionin me raportin e ndeshjes.

39.4. Me kërkesë të Komisionit të Garave vëzhguesi dhe gjyqtarët janë të obliguar të dërgojnë raportin plotësues në afat sa më të shkurt, një (1) orë pas përfundimit të ndeshjes apo më së voni deri në orën 12:00 të ditës së ardhshme.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





PERSONAT ZYRTARË NË NDESHJE

NENI 40 - VËZHguesI

40.1. Detyrën e vëzhguesit në ndeshje e kryen personi i cili gjendet në listën e propozuar nga ana e Shoqatës së Gjyqtarëve të FBK-së, e aprovuar nga Bordi i FBK-së. Nëse ndodhë që në ndeshje nuk është prezent Vëzhguesi i ndeshjes për çfarëdo arsye, atëherë kompetencat e vëzhguesit i merr gjyqtari i parë.

40.2. Delegimin e vëzhguesve në të gjitha ndeshjet e bën Komesari i Garave i FBK-së. Vëzhguesi në garat e organizuara sipas këtyre Propozicioneve gjithmonë është i obliguar të paraqitet me veshje formale dhe të respektojë kodeksin e veshjes.

40.3. Vëzhguesi delegohet në ndeshje për të siguruar rrjedhjen normale të saj sipas kritereve të parapara dhe duhet të bashkëpunojë me gjyqtarë para, gjatë dhe pas ndeshjes. Gjatë ndeshjes është i ulur në mes të procesmbajtësit dhe kohëmatësit.

40.4. Vëzhguesi është përgjegjës për:

40.4.1. Punën dhe funksionimin e gjyqtarëve ndihmës në tavolinën zyrtare;

40.4.2. Kontrollimin e licencave MAP të lojtarëve dhe personave zyrtarë të paraqitur në ndeshje;

40.4.3. Sigurimin e dokumentacionit të kërkuar;

40.4.4. Garantimin se në bankinë nuk do të ulet personi i cili nuk posedon licencë;

40.4.5. Të kërkuar largimin e të gjithë personave të cilët mund të pengojnë mbarëvajtjen e ndeshjes.

40.5. Vëzhguesi mund të zëvendësojë gjyqtarin ndihmës, nëse konstaton se është duke gabuar dhe me këtë ndikon në rrjedhjen e rregullt të ndeshjes.

40.6. Në rastin e përshkruar në paragrafin paraprak bëhet pushimi për zëvendësimin e gjyqtarit ndihmës.

40.7. Vëzhguesi e bënë zëvendësimin prej gjyqtarëve ndihmës apo gjyqtarëve të pranishëm në sallë. Nëse para fillimit të ndeshjes në terminin e caktuar nuk paraqitet një gjyqtar, apo me shumë, vëzhguesi bënë zëvendësimin me gjyqtarët e pranishëm nga lista e përcaktuar. Nëse në afat prej 60 minutave nuk plotësohen kushtet nga alineja e mëparshme që të fillojë apo vazhdojë ndeshja, Vëzhguesi është i obliguar që ta lajmërojë Komesarin e Garave për caktimin e gjyqtarit-ëve tjerë. Shpenzimet për shtyrjen (pezullimin) e ndeshjes do t'i bartë FBK.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





40.8. Vëzhguesi ka për detyrë:

40.8.1. Të vëzhgojë situatën tek shikuesit dhe ne rast të nevojës t'i lajmërojë gjyqtarët për të ndërmarrë masa me kohë;

40.8.2. Që në raportin e tij të jep vlerësimin për organizimin e ndeshjes. Është i obliguar që të përshkruaj çdo moment diskutabil;

40.8.3. Që të paraqet kryerësin e shkeljeve të rënda;

40.8.4. Që të njoftojë për rezultatin përfundimtar në pajtim me nenin 39.1. të këtyre Propozicioneve;

40.8.5. Nëpërmjet përfaqësuesit zyrtar duhet të sigurojë deklaratat për personat e paraqitur apo të përjashtuar nga loja, të cekë momentet dhe rastet kontestuese për sjellje jo sportive dhe të njëjtat t'i nënshkruan dhe më së voni 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes dhe t'ia dorëzojë vëzhguesit. Në raste të këtilla deklarata merret edhe nga gjyqtarët, e sipas nevojës edhe nga personat tjerë zyrtarë dhe anëtarët e ekipeve.

40.9. Në afat prej 48 orëve Vëzhguesi i ndeshjes është i obliguar t'i dorëzojë (dërgojë) në FBK këto dokumente:

40.9.1. Protokollin origjinal dhe Raportin e Vëzhguesit;

40.9.2. Fletëparaqitjet e lojtarëve dhe personave zyrtarë të dy ekipeve të paraqitur për ndeshje;

40.9.3. Në të gjitha garat ku është obligative mbajtja e statistikave.

40.9.4. Raportet plotësuese nëse nuk ka mjaft hapësirë në formularin e Raportit të vëzhguesit, apo vërejtjet plotësuese të perceptuara pas kompletimit të Raportit.

40.10. Në rast ankese, Vëzhguesi është i obliguar t'i dërgojë në FBK, më së voni 1 (një) orë pas përfundimit të ndeshjes të skanuara në emali apo më së voni 24 orë pas ndeshjes t'i dorëzojë në origjinal këto dokumente:

40.10.1. Ankesën në formë shkrimi;

40.10.2. Deklaratat e personave zyrtarë për ngjarjen kontestuese;

40.10.3. Protokollin e ndeshjes;

40.10.4. Raportin e Vëzhguesit.

40.11. Vëzhguesi është i obliguar të arrijë në palestrën ku do të zhvillohet ndeshja një (1) orë para fillimit të ndeshjes.

40.12. Vëzhguesve iu ndalohet komentimi i të gjitha detajeve në lidhje me ndeshjen e zhvilluar dhe me detajet e cekura në raportin e vëzhguesit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





40.13. Pas përfundimit të ndeshjes, gjyqtarët dhe gjyqtarët ndihmës mund ta braktisin fushën e lojës vetëm pas lejitimit të vëzhguesit të ndeshjes.

40.14. Për përgjegjësinë disiplinore të vëzhguesit vendos Komisioni i Garave dhe Bordi i FBK-së në raste të veçanta.

40.15. Vëzhguesi, menjëherë pas përfundimit të ndeshjes (ndeshjet e Superligës) është i obliguar që Komesarit të Garave t'ia dërgojë Raportin e Vëzhguesit me anë të postës elektronike.

NENI 41 - GJYQTARËT

41.1. Gjyqtarët në ndeshje janë të obliguar të paraqiten me veshje formale dhe konform kodeksit të veshjes. Listën e gjyqtarëve për ndarjen e drejtësisë në ndeshje, me propozim të Shoqatës së Gjyqtarëve të FBK-së, e miraton Bordi i FBK-së. Vetëm gjyqtarët e SHGJFBK-së të cilët i janë nënshtruar testeve psike fizike-testimeve nga njohja e rregullave të basketbollit kanë të drejtën e ndarjes së drejtësisë në të gjitha garat të cilat organizohen nga FBK.

41.2. Delegimin e gjyqtarëve e bënë Komesari i Garave në bazë të listës së aprovuar nga Bordi i FBK-së.

41.3. Klubet nuk mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve dhe vëzhguesve nga lista e aprovuar nga Bordi i FBK-së, apo nga ndeshja në të cilën është deleguar.

41.3.1. Gjyqtari i parë 20 minuta para fillimit të ndeshjes, gjegjësisht me paraqitjen në fushën e lojës në palestër duhet të ndajë topin e lojës me të cilin do të zhvillohet ndeshja.

41.4. Gjyqtari i parë është përgjegjës për marrjen e masave dhe sanksionimin për anim josportiv, ofendime racore, sjelljet e shikuesve dhe është i obliguar në rastet e cekura të marr masat adekuate duke:

- Vërejtja e parë me anë të zërimit (pas hedhjeve, cenimit të terrenit, ofendimeve racore ose etnike, etj.);
- Dhënia e vërejtjes së dytë shikuesve përmes trajnerit kryesor apo kapitenit të ekipit, përndryshe pjesa tjetër largohet në teshatore për 5min;;
- Largimin e një apo më shumë individëve nga palestra;
- Zbrazjen e një pjese të shikuesve;
- Zbrazjen e palestrës;
- Ndërprerjen e ndeshjes.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





41.5. Gjyqtarët janë plotësisht të pavarur për marrjen e vendimeve dhe janë të obliguar që me çdo kusht, nëse ekzistojnë kushtet normale, ta sjellin ndeshjen gjerë në përfundim të saj. Nëse gjyqtari është lënduar apo për ndonjë arsye tjetër nuk mund të vazhdojë të kryejë detyrën e tij në kohë prej 5 minutave nga situata e krijuar, ndeshja do të vazhdojë. Gjyqtarët tjerë vazhdojnë gjykimin për kohën e mbetur, përveç nëse ka mundësi zëvendësimi i gjyqtarit me një gjyqtar të kualifikuar. Gjyqtarët e mbetur vendosin për zëvendësimin e gjyqtarit pas konsultimeve me vëzhguesin e ndeshjes nëse ai është prezent në ndeshje.

41.6. Gjyqtari i parë posaçërisht është përgjegjës për fushëveprimin e tij, të përcaktuar me rregullat zyrtare të lojës. Gjyqtari i parë është përgjegjës mes tjerash për:

41.6.1. Sjelljen e lojtarëve dhe personave zyrtarë që janë të ulur në bankinë;

41.6.2. Të vendosur për ndërprerjen e ndeshjes dhe për zbrazjen e pjesërishme apo të tërësishme të shikuesve, për anim jo sportiv dhe vulgarë, sharje në kor apo ofendime racore e kombëtare drejtuar ndonjërit prej ekipeve gjyqtarëve, personave zyrtarë dhe punëtorëve tjerë të basketbollit, si dhe pështymja apo hedhja/spërkatja me lëngje dhe hedhja e gjësendeve të forta në fushë, me të cilën rrezikohet siguria e pjesëmarrësve në ndeshje (pas vërejtjes së parë të dhënë me anë të zërimit zyrtar).

41.6.3. Gjyqtari i parë në rastin e zbrazjes së pjesërishme apo të tërësishme të shikuesve, vë në dispozicion të organizatorit kohën për të reaguuar për përmirësimin e situatës (15 minuta) dhe nëse gjatë kohës së dhënë nuk ofrohen kushte për vazhdimin e ndeshjes, ndeshja do pezullohet dhe do të zhvillohet brenda 24 orëve pa prezencën e shikuesve prej kohës dhe rezultatit në momentin e ndërprerjes së ndeshjes, në pajtim me nenin 19.3. të këtyre Propozicioneve.

41.6.4. Në rast të cenimit të fushës së lojës nga individë të paautorizuar, apo përdorimit të pajisjeve piroteknike, mjeteve të forta ose objekteve tjera që rrezikojnë pjesëmarrësit e ndeshjes, Gjyqtari i Parë në konsultim me vëzhguesin ka të drejtë të ndërpresë ndeshjen pa tërhequr vërejtjen paraprakisht dhe të bëjë zbrazjen e plotë apo pjesërishme të palestrës.

41.6.5. Vendosë për ndërprerjen e ndeshjes dhe për zbrazjen e pjesërishme apo të tërësishme të palestrës në rast të incidenteve në fushë dhe jashtë saj. Në këto raste, gjyqtarët janë të obliguar që ndeshjen ta vazhdojnë me zbrazjen e pjesërishme apo të tërësishme (totale) të palestrës, e nëse nuk ekzistojnë kushtet për vazhdimin e saj, ndeshja do të zhvillohet brenda 24 orëve pa prezencën e shikuesve prej kohës dhe rezultatit në momentin e ndërprerjes së ndeshjes. Shpenzimet e ekipit dhe personave zyrtarë për vazhdimin e ndeshjes në këto rrethana do t'i bartë ekipi e cila është fajtor për ndërprerjen e ndeshjes.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





41.6.6. Me realizimin e sulmit fizik ndaj personave zyrtarë (lojtarëve apo personave zyrtarë të ekipeve, gjyqtarëve, vëzhguesit, zyrtarëve të FBK apo personave të deleguar nga FBK) nga shikuesit ose me shkaktimin e lëndimit të rëndë nga gjësendet e hedhura të cilat lëndojnë personat zyrtarë, lojtarin-lojtaren, trajnerin ose ndonjërin nga anëtarët e ekipit ndeshja ndërpritet menjëherë, pa vazhdim, me vendimin e marrë nga Gjyqtari i Parë. Ekipi përgjegjës për ndërprerjen e ndeshjes humb ndeshjen me rezultat zyrtar dhe nuk i takon asnjë pikë në tabelën e klasifikimit.

41.7. Gjyqtarët janë të obliguar të arrijnë në palestër ku do të zhvillohet ndeshja një orë para fillimit të saj, e 20 minuta para fillimit, të dalin në fushë në veshje të gjyqtarëve, matësi i kohës e lëshon orën për matjen e kohës.

41.8. Nuk lejohet që gjyqtarët të kenë veshje (uniformë) të ndryshme gjatë ndeshjes.

41.9. Gjyqtarët janë të obliguar që t'i zbatojnë në tërësi rregullat e lojës dhe Interpretimin e tyre nga ana e FIBA-s, si dhe mos të lejojnë shkeljen e dispozitave të këtyre Propozicioneve dhe akteve tjera normative të FBK-së.

41.10. Gjyqtarët duhet të kenë kujdes në pajtim me rregullat që:

41.10.1. Fanellat e lojtarëve të jenë të njëjta;

41.10.2. Të mos lejohet inkuadrimi në fushë i lojtarit që nuk është i veshur si lojtarët tjerë të ekipit;

41.10.3. Të ketë rregullsi në fushë dhe punën e tavolinës zyrtare;

41.10.4. Sjelljet e të gjithë personave në bankinat e të dy ekipeve të jenë të përshtatshme dhe në pajtim me rregullat e lojës.

41.11. Gjyqtari, i cili ka marr vendim për përjashtimin e lojtarit, trajnerit, personit zyrtar, apo ka paraqitur ndonjërin nga personat e cekur në fletë paraqitje, duhet ta lajmërojë (njoftojë) vëzhguesin me arsyet e vendimit të marrë apo paraqitjes me shkrim.

41.12. Gjyqtarët janë të obliguar që në ftesë të vëzhguesit, t'i përshkruajnë të gjitha momentet (rastet) kontestuese të cilat kanë ndodhë në ndeshje, që të përshkruajnë arsyet për gabimet e dhëna teknike dhe përjashtimet (diskualifikimet) e lojtarëve, trajnerëve dhe përfaqësuesve zyrtar, si dhe vendimet tjera të rëndësishme të cilat nuk kanë të bëjnë me rrjedhën e ndeshjes (zbrazja e pjesërishme apo e tërësishme e shikuesve, etj.).

41.13. Gjyqtarët dhe vëzhguesi nuk guxojnë të udhëtojnë në ndeshje me mjetin transportues (automobilin, autobusin etj.) të ekipit e cila gjykohet nga ta.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





41.14. Komisioni i Garave i fton në përgjegjësi dhe i ndëshkon në shkallë të parë gjyqtarët të cilët nuk i respektojnë dispozitat e rregullave të basketbollit, dhe nuk e kryejnë detyrën e tyre sipas këtyre Propozicioneve.

41.15. Komisioni i Garave, në shkallë të parë i ndëshkon gjyqtarët të cilët bëjnë shkeljen e Rregullave të Lojës. Për vlerësimin e gjyqtarit me notë të dobët, gjyqtari ndëshkohet edhe mospranim të taksës së gjykimit për ndeshjen në fjalë.

41.16. Gjyqtarëve iu ndalohet komentimi i të gjitha detajeve lidhur me ndeshjen e zhvilluar dhe me detajet e cekura në raportin e ndeshjes.

41.17. Pas përfundimit të ndeshjes, gjyqtarët mund ta braktisin fushën vetëm me lejin e vëzhguesit.

41.18. Pas përfundimit të ndeshjes gjyqtarët e nominuar në ndeshjet e Superligës janë të obliguar që brenda 48 orëve të dërgojnë formën e evaluimit nga ndeshja e nominuar, kurse brenda 24 orëve gjatë ndeshjeve të play off-it.

NENI 42 - GJYQTARËT NDIHMËS

42.1. Gjyqtarët ndihmës në ndeshje i cakton ekipi vendës, nga mesi i personave të kualifikuar dhe licencuar (sipas rastit) për kryerjen e punëve në tavolinën zyrtare.

42.2. Gjyqtarët ndihmës duhet të jenë të veshur në mënyrë uniforme, me rroba me ngjyrë të njëjtë.

42.3. Gjyqtarët ndihmës të cilët nuk i respektojnë dispozitat e Rregullave të basketbollit dhe detyrën e tyre nuk e kryejnë sipas këtyre Propozicioneve, do të ftohen në përgjegjësi disiplinore dhe do të ndëshkohen nga Komisioni i Garave.

42.4. Vëzhguesi i ndeshjes ka të drejtë të përjashtojë nga tavolina zyrtare gjyqtarët të cilët nuk i respektojnë dispozitat e rregullave të basketbollit dhe detyrën e tyre nuk e kryejnë sipas këtyre Propozicioneve. Në këtë rast klubi ka 30 minuta kohë që të gjejë zëvendësimin për gjyqtarin ndihmës të përjashtuar.

42.5. Pas përfundimit të ndeshjes, gjyqtarët ndihmës mund ta braktisin fushën vetëm me lejin e vëzhguesit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 43 - SHPENZIMET E UDHËTIMIT, TAKSAT DHE MËDITJET

43.1. Gjyqtarëve, vëzhguesve dhe kontrollorëve iu takojnë taksat, mëditjet dhe shpenzimet e udhëtimit.

43.2. Gjyqtarëve, vëzhguesve dhe kontrollorëve të cilët kryejnë detyrën e tyre në ndeshjen e cila zhvillohet në qytetin e tyre, iu takon mëditja.

43.3. Gjyqtarët ndihmës ose zëvendësuesit e tyre eventual të cilët i cakton skuadra vendase, njëherësh e bënë edhe pagesën e taksës së tyre.

43.4. Lartësinë e taksës, mëditjes dhe shpenzimeve të udhëtimit e përcakton Bordi i FBK-së me vendim.

43.5. Taksa për angazhimin potencial të gjyqtarëve të huaj do të caktohet përmes marrëveshjes reciproke të Komisionit të Garave dhe Federatës Nationale përkatëse.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





ANKESA NË NDESHJE

NENI 44 - ANKESA NË NDESHJE

44.1. Konform Rregullave Zyrtare të lojës së basketbollit, ankesë mund të paraqes ekipi i cili mendon se është dëmtuar nga:

44.1.1. një gabim në udhëheqjen e procesverbalit të ndeshjes (DSS), matjes së kohës ose matjes së kohës së sulmit, i cili nuk është korrigjuar nga gjyqtari i ndeshjes;

44.1.2. një vendim për të humbur ndeshjen e pa-zhvilluar, për të anuluar, për të shtyrë, për të mos rifilluar ose për të mos luajtur ndeshjen;

44.1.3. paraqitja e lojtarit i cili nuk është regjistruar sipas Rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve, apo me paraqitjen e lojtarit të dënuar.

44.2. Ankesa nuk mund të parashtrohet ndaj vendimeve faktike (kriterit) të gjyqtarëve.

44.3. Ankesa në ndeshje paraqitet si në vijim:

44.3.1. Kapiteni i skuadrës duhet të nënshkruhet menjëherë në vendin e caktuar në Procesverbalin e ndeshjes (DSS), më së voni 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes.

44.3.2. T'ia dorëzojë vëzhguesit me shkrim sqarimet e ankesës më së voni 1 orë pas përfundimit të ndeshjes. Pastaj, personat zyrtarë të ndeshjes (gjyqtarët dhe vëzhguesi), secili veç e veç, duhet të japin mendimin me shkrim në lidhje me ankesën, e në rast të kërkesës me shkrim të Komisionit të Garave, edhe raportin plotësues dhe prova mbi bazën e të cilave Komisioni do të marrë vendim më lehtë.

44.3.3. Klubi duhet të bëjë deponimin e shumës në lartësi prej 500,00€ në llogarinë e FBK-së më së voni në ditën e parë të punës pas përfundimit të ndeshjes.

44.3.4. Klubi mundet, por nuk është i obliguar, të dorëzojë plotësimet apo detajet e ankesës më së voni ditën e parë të punës pas përfundimit të ndeshjes.

44.4. Ankesa, e cila nuk është lajmëruar me nënshkrimin e kapitenit të ekipit, nuk i është dhënë me kohë vëzhguesit të ndeshjes dhe për të cilën nuk është bërë deponimi i shumës në afatin e caktuar, do të refuzohet dhe nuk do të merret parasysh.

44.5. Për përcaktimin e kohës së të deponimit të shumës për ankesë do të merret parasysh fletëpagesa postare apo bankare.

44.6. Komisioni i Garave mund të marrë vendim për miratimin e ankesës apo refuzimin e saj.

44.7. Nëse ankesa miratohet, Komisioni i Garave mund të urdhërojë zhvillimin e serishëm të ndeshjes apo do të regjistrojë me rezultat zyrtar nëse për këtë plotësohen kushtet e

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





përcaktuara me këto propozicione, Rregulloren e Garave dhe Rregullat Zyrtare të Basketbollit. Në rast se ankesa e parashtruar miratohet nga ana e Komisionit të Garave, bëhet kthimi i mjeteve të deponuara në shumë prej 500,00€.

44.8. Nëse ankesa refuzohet Komisioni i Garave do të regjistrojë ndeshjen me rezultatin e arritur.

44.9. Vendimin për ankesën e ndeshjes, Komisioni i Garave duhet ta marrë më së voni 72 orë pas përfundimit të ndeshjes.

44.10. Në ndeshjet e play-offit, turnetë finale apo në ritëm të zhvillimit të ndeshjeve që kërkon reagim të shpejtë, Komisioni i Garave vendimet duhet t'i sjellë në afat prej 24 orëve pas përfundimit të ndeshjeve, e me këtë duhet të dorëzohen të gjitha dokumentet e nevojshme (ankesa, deklaratat e akterëve, personave zyrtarë, etj.), duhet t'i dorëzohen Komisionit të Garave para afatit të përcaktuar këtu.

44.11. Nëse gjatë ndeshjes ka ndodhur shkelje e rëndë materiale të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes dhe si rezultat i këtyre shkeljeve materiale rezultati i arritur nuk është sipas konkurrencës sportive, Komisioni i Garave do ta aprovojë ankesën dhe do të kërkojë zhvillimin e ndeshjes së re, kurse skuadrës e cila ka paraqitur ankesë mjetet e deponuara për ankesë do t'i kthehen. Këtu nuk do të merret parasysh kriteri i gjyqtarëve gjatë ndeshjes sipas ndarjes së dënimeve, shkeljeve dhe performancës së tyre. Për shkak të paraqitjes objektive të fakteve rreth procedurës së ankimit, Komisioni i Garave mund të kërkojë nga SHGJFBK, një instruktor i gjyqtarëve i FIBA apo nga një komision i caktuar vlerësimin mendimin profesional (ekspertizën e gjykimit), në afat prej 48 orësh pas përfundimit të ndeshjes).

NENI 45 - ANKESA NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË GARAVE

45.1. Në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit.

45.2. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.

45.3. Ankesa e cila nuk është dorëzuar me kohë tek Komisioni i Arbitrazhit, apo për të cilën nuk është deponuar shuma e caktuar refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





45.4. Komisioni i Arbitrazhit vendimin e merr në afat prej 48 orësh nga pranimi i Ankesës. Vendimi i Arbitrazhit është përfundimtar dhe pa të drejtë anekese.

45.5. Në vendimin e Komisionit të Arbitrazhit, pala e pakënaqur gëzon të drejtën e parashtrimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë para Bordit të FBK-së, por vetëm në rastin kur mendon se vendimi i Arbitrazhit ka bërë shkelje materiale të akteve normative të FBK-së.

45.6. Gjatë play-off-it, garave të sistemit të kupës apo kurdo që ritmi garues këtë e dikton, pas ankesës së dorëzuar të ekipit, në ftesë të Sekretarit të Përgjithshëm, Komisioni i Arbitrazhit mbledhet dhe menjëherë merr vendim për ankesën e dorëzuar.

45.7. Nëse ankesa aprovet, shumta e deponuar do t'i kthehet paraqitësit të ankesës.

45.8. Ankesat në vendimin e Komisionit të Garave në ndeshjet finale paraqiten dhe shumta deponohen njësoj sikur të pjesa e rregullt e garave.

45.9. Komisioni i Garave vendimet e veta i shpall nëpërmjet postës elektronike dhe në ueb-faqe të FBK-së.

45.10. Në këto vendime paraqitësi i ankesës ka të drejtë anekese në afat prej 24 orëve nga pranimi i vendimit, apo dita e publikimit në ueb-faqen e FBK-së.

45.11. Ankesa në ndeshjet e play-off paraqitet me anë të postës elektronike, apo dorëzohet me shkrim në afat i cili nuk pengon zhvillimin e rregullt të garave.

45.12. Vendimi i Komisionit të Arbitrazhit i dërgohet klubeve të garës përkatëse me anë të postës elektronike dhe publikohet në ueb-faqen e FBK-së. Vendimi nënkuptohet i shpallur në momentin kur i është dërguar klubit apo është publikuar në ueb-faqen e FBK-së.

45.13. Komisioni i Garave dhe Komisioni i Arbitrazhit kanë të drejtë të miratojnë rregulloret e tyre të punës për të garantuar efikasitet të shtuar në kryerjen e detyrave të veta.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 46 - REGJISTRIMI I NDESHJEVE

46.1. Komisioni i Garave bën regjistrimin e ndeshjeve në bazë të raporteve të pranuar nga vëzhguesit e ndeshjeve dhe në bazë të akteve normative të FBK-së.

46.2. Të gjitha ndeshjet për të cilat ekzistojnë ankesat apo rastet tjera të cilat nuk lejojnë regjistrimin e ndeshjes, Komisioni i Garave është i obliguar që t' i regjistrojë në afatin sa më të shkurtër, më së voni 7 ditë pas përfundimit të xhiros apo të ndeshjes.

46.3. Në rast kur është paraqitur ankesa apo ekzistojnë raste të tjera për të cilat ndeshja nuk mund të jetë e regjistruar, afati i regjistrimit shtyhet (pezullohet) deri në ditën e marrjes së vendimit, gjegjësisht deri në marrjen e vendimit për zgjedhjen e rastit për të cilin ndeshja nuk është regjistruar.

46.4. Të gjitha ndeshjet për të cilat nuk ka ankesa apo raste të tjera të cilat nuk lejojnë regjistrimin e ndeshjes, Komisioni i Garave është i obliguar që t' i regjistrojë 48 orë pas përfundimit të ndeshjeve.

46.5. Njëherë ndeshja e regjistruar apo vendimi i marrë nuk mund të anulohet nga ana e organit të njëjtë.

NENI 47 - MËNYRA E NDARJES SË PIKËVE, PËRCAKTIMI I PLASMANIT

47.1. Mënyra e ndarjes së pikëve dhe përcaktimi i plasmanit të ekipeve në sistemin e garave bëhet në bazë të dispozitave, të Rregullave zyrtare të basketbollit, dhe këtyre Propozicioneve.

47.1.1. Nëse dy ekipe në fund kanë grumbulluar numër të njëjtë të pikëve, renditja e tyre do të përcaktohet në bazë të ndeshjeve të zhvilluara në mes tyre;

47.1.2. Nëse numri i fitoreve në ndeshjet në mes tyre është i barabartë, atëherë renditja përcaktohet në bazë të koshdiferencës në ndeshjet ndërmjet tyre. Nëse koshdiferenca në ndeshjet e zhvilluara në mes tyre është e njëjte, atëherë renditja përcaktohet në bazë të koshdiferencës duke llogaritur shënimet e arritura në të gjitha ndeshjet e ndërsjella;

47.1.3. Koshdiferenca llogaritet duke zbritur numrin e koshave të shënuar me numrin e koshave të pësuar;

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





47.1.4. Nëse më shumë se dy ekipe kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve, renditja përcaktohet vetëm në bazë koshdiferencës të pikëve të shënuara ndeshjet në mes tyre;

47.1.5. Nëse më shumë se dy ekipe kanë tubuar numër të njëjtë të pikëve dhe numri i fitoreve në ndeshjet në mes tyre është i barabartë, renditja përcaktohet në bazë të në bazë të kosh dallimit më të madh të pikëve nga të gjitha ndeshjet e zhvilluara në grup.

47.1.6. Nëse më shumë se dy ekipe kanë numër të barabartë të fitoreve dhe koshdiferencë të njëjtë në ndeshjet e zhvilluara në mes tyre, renditja përcaktohet në bazë të shënimit më të madh të pikëve nga loja në të gjitha ndeshjet e zhvilluara në grup.

47.1.7. Nëse pas përfundimit të garave këto kritere edhe më tutje nuk mund të vendosin plasmanin përfundimtar, atëherë plasmani përfundimtar do të përcaktohet në bazë të hedhjes së shortit.

47.1.8. Procedurën e hedhjes së shortit e cakton dhe e zbaton Komisioni i Garave në prani të Përfaqësuesve të ekipeve;

47.2. Mënyra e përcaktimit të plasmanit të ekipeve do të zbatohet në pjesën e parë të edicionit, pas zhvillimit të të gjitha ndeshjeve, dhe pas përfundimit të edicionit garues.

47.3. Në përputhje me suksesin në garën e caktuar, ekipet kalojnë prej një rangu në rangun tjetër. Në rast që klubi i një rangu të caktuar heq dorë nga garat para fillimit të kampionatit, apo vjen deri te zgjerimi i Ligës, për mënyrën e plotësimit eventual vendos Bordi i FBK-së.

47.4. Skuadra e cila në fund të sezonit kalon në nivel më të ulët, në sezonin e ardhshëm nuk mund të kthehet, gjegjësisht të garojë në nivelin e njëjtë të garave. Përjashtim nga ky rast bëhet nëse ekipet nga rangu më i ulët nuk i plotësojnë kushtet e garimit për nivel më të lartë, ose përcaktohen kushte për Wild Card nga Bordi i FBK-së. Ekipi i cili është përjashtuar nga garat para fillimit apo gjatë sezonit të garave, nuk mund në sezonin e ardhshëm të kthehet dhe të garojë në nivelin e njëjtë, përveç nëse përcaktohen kushte për Wild Card nga Bordi i FBK-së.

47.5. Ekipit kampion të Superligës (meshkuj/femra) dhe fituesit të Kupës së Kosovës u takon shpërblimi financiar vlerën e së cilit e cakton Bordi i FBK-së para fillimit të edicionit. Bordi i FBK-së para fillimit të edicionit mund të vendosë edhe për shpërblime ose fonde të shpërblimeve që përfshijnë edhe klubet ose ligat tjera.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





DISPOZITAT FINANCIARE

NENI 48 - PAGESAT DHE SANKSIONET PËR SHKELJE

48.1. Klubet janë të obliguara që detyrimet e tyre financiare të akumuluar ndaj FBK dhe FIBA t'i paguajnë si parakusht për licencim për garim në edicionin vijues. Klubet detyrohen që të paguajnë borxhet nga edicionet e kaluara sipas Marrëveshjes për Shlyerjen e Obligimeve ndaj FBK-së dhe konform kriterëve për licencim të përcaktuara për edicionin e ri nga Bordi i FBK-së si dhe në bazë të akteve tjera normative të FBK-së.

48.2. Klubet janë të obliguara që detyrimet e tyre financiare për dënimet e shqiptuara në ndeshjet e rregullta të edicionit garues t'i paguajnë jo më vonë se 4 orë para fillimit të ndeshjes vijuese të tyre në cilëndo garë të organizuar nga FBK.

48.3. Klubet janë përgjegjëse për të gjitha obligimet financiare të shqiptuara pjesëtarëve të vet (lojtarët, trajnerët, zyrtarët, etj.).

48.4. Pagesa e dënimeve dhe obligimeve tjera materiale, bëhet nëpërmjet transferit bankar në xhirollogarinë zyrtare të FBK-së dhe dëshkohet me parashtrimin e kopjeve të skanuara të transferit bankar të lëshuar zyrtarisht nga banka në të cilën është kryer transferi. Asnjë formë tjetër e pagesës apo dëshmimit të pagesës nuk është e lejuar, ndërsa çfarëdo mashtrimi i mundshëm në kuptim të zbatimit të këtij paragrafi do të rezultojë me suspendim dhe masa disiplinore të menjëhershme për klubin dhe personat përgjegjës të tij.

48.5. Mos-pagesa e obligimeve financiare brenda afateve të caktuara në këtë nen do të rezultojë me suspendim të përkohshëm të klubit që ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të veta financiare të pagesës, dhe/ose të pjesëtarit të klubit që ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të veta të pagesës. Gjatë kohës së suspendimit klubi dhe/ose pjesëtarit i tij, nuk ka të drejtë paraqitjeje në asnjë aktivitet apo garë të organizuar nga FBK.

48.6. Në rastet kur klubi ka dështuar në përmbushjen e obligimeve të veta financiare sipas paragrafit 48.2 më sipër, Komesari i Garave do ta njoftojë ekipin kundërshtar të klubit që të mos udhëtojë për ndeshje në rastet kur klubi i pezulluar është vendas, respektivisht që të mos organizojë ndeshjen në rastet kur klubi i pezulluar është mysafir. Komesari i Garave njofton Komisionin e Garave, si dhe të gjithë zyrtarët e nominuar në ndeshje, ekipet televizive dhe mediat e akredituara për mos-zhvillimin e ndeshjes. Klubi i pezulluar humbë ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0 dhe nuk merr pikë për këtë ndeshje, sipas rregullave të lojës.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:



48.7. Në rast se dy ekipe nuk i kanë përmbushur obligimet financiare dhe të njëjtat duhet të zhvillojnë ndeshjen në mes veti, do të suspendohen deri në përmbushjen e obligimeve, ndeshja do të regjistrohet me rezultat 2:0 kundër të dy ekipeve dhe nuk do të marrin një (1) pikë të paraparë për humbje.

48.8. Suspendimi konsiderohet i tejkaluar me automatizëm pas kryerjes së pagesës sipas këtij neni, ndërsa ekipi dhe/ose pjesëtari përkatës i tij rifiton të drejtën e pjesëmarrjes në gara sipas këtyre Propozicioneve.

NENI 49 - ANKESA NË VENDIMIN E SUSPENDIMIT TË KLUBIT

49.1. Kundër vendimit të Komisionit të Garave për suspendimin e klubit për shkak të mos pagesës së obligimeve sipas nenit 48 më sipër, klubi ka të drejtë ankese në Komisionin e Arbitrazhit të FBK-së në afat prej 24 orëve nga marrja e vendimit, duke iu përmbajtur detyrimeve për paraqitje të ankesave në Komisionin e Arbitrazhit. Ankesa nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

49.2. Komisioni i Arbitrazhit bën shqyrtimin e ankesës në vendimin për suspendim e ekipit në afat prej 48 orësh pas marrjes së ankesës. Vendimi i Komisionit të Arbitrazhit është përfundimtar.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





SHKELJET DHE DËNIMET

NENI 50 - SHKELJET DHE DËNIMET PËR ORGANIZIM TË DOBËT TË NDESHJES

Nr.	Përshkrimi i shkeljes	SL	SLF/L1	L1F/L2
50.1.	Paraqitja me vonesë e ndeshjes	100 €	50 €	30 €
50.2.	Ndërrimi i terminit 48 orë para ndeshjes	100 €	50 €	30 €
50.3.	Mosaktimi i personit zyrtar pritës i ekipit mysafir	100 €	40 €	30 €
50.4.	Mungesa e mjekut kujdestar/fizioterapeutit të licencuar	500 €	50 €	40 €
50.5.	Mungesa/pamjaftueshmëria e pjesëtarëve të PK-së dhe sigurimit gjatë ndeshjes	500 €	100 €	50 €
50.6.	Shërbimi i dobët i kujdestarisë	500 €	200 €	80 €
50.7.	Mungesa e personit dhe pajisjes për pastrimin e fushës	100 €	40 €	30 €
50.8.	Mossigurimi i zhveshtoreve për skuadrën mike dhe gjyqtarët	200 €	50 €	40 €
50.9.	Organizimi i dobët i tavolinës zyrtare (mungesa e 1 kohëmatësi, 1 operatori të 24-shit, dhe 1 operatori DSS)	200 €	100 €	80 €
50.10.	Mos-udhëheqja digjitale e procesverbalit DSS	100 €	50 €	/
50.11.	Pengimi i punës së zyrtarëve, vëzhguesit dhe gjyqtarëve para, gjatë dhe pas ndeshjes	400 €	150 €	100 €
50.12.	Mos vendosja e flamurit shtetëror dhe mos-intonimi i himnit shtetëror	500 €	100 €	50 €
50.13.	Mossigurimi i ftesave për FBK dhe ekipin mysafir	500 €	200 €	100 €
50.14.	Mossigurimi i topave për ekipin mysafir dhe mossigurimi i topit zyrtar për ndeshje	200 €	100 €	100 €

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



50.15.	Mosparaqitja e logove të miratuara nga FBK në fanellat e lojtarëve, përfshirë këtu flamurin e Republikës së Kosovës	400 €	50€	50€
50.16.	Mungesa e aparateve teknike dhe ndihmëse/aparatet jofunksionale	500 €	50 €	50 €
50.17.	Mungesa apo mosfunksionimi i ndriçimit LED në konstruksion të koshit	400 €	-	-
50.18.	Organizimi i përgjithshëm i dobët sipas konstatimit të vëzhguesit	500 €	200 €	50 €
50.19.	Mos-paraqitja e MAP-it të vëzhguesi i ndeshjes me fotot dhe të dhënat e lojtarëve 1 orë para ndeshjes, ose mos-paraqitja e listës paraqitëse	100 €	50 €	20 €
50.20.	Mos-njoftimi i paraqitjes së 5 lojtarëve të huaj 24 orë para fillimit të ndeshjes	200 €	-	-
50.21.	Ndriçimi i pamjaftueshëm në palestër gjatë ndeshjes	400 €	100 €	50 €
50.22.	Mosrespektimi i detyrimit për xhirim të ndeshjes, sipas formatit të kërkuar	-	100 €	50 €
50.23.	Mossigurimi i lokalit dhe kompjuterit për përpilim të raportit të ndeshjes	200 €	100 €	50 €
50.24.	Mossigurimi i dhomës së përshtatshme për kontrollë të dopingut	100 €	50 €	30 €
50.25.	Mosfunksionimi/largimi i sistemit të zërimit gjatë ndeshjes, pas kërkesës së vëzhguesit për dhënie të vërejtjes shikuesve për sjelljes jospportive	1000 €	200 €	50 €
50.26.	Mosfunksionimi i internetit dhe mos-sigurimi i printerit (për printimin e statistikave live) në palestër gjatë ndeshjes	500 €	100 €	50

50.27. Shkeljet e këtyre Propozicioneve për organizim të dobët të ndeshjes janë shkelje mandatare të cilat sanksionohen nga Komisioni i Garave me automatizëm pas pranimit të raportit të vëzhguesit. Dënimet për shkeljet e Propozicioneve sipas këtij neni dyfishohen pas përsëritjes së tretë të tyre nga klubi apo pjesëtari përkatës. Për vendimet e Komisionit të Garave mbi shkeljet e Propozicioneve sipas këtij neni nuk lejohet ankesa.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



NENI 51 - SHKELJET DHE DËNIMET PËR SJELLJE TË SHIKUESVE DHE CENIM TË FUSHËS SË LOJËS

Nr.	Përshkrimi i shkeljes	SL	SLF/L1	L1F/L2
51.1.	Thithja/konsumimi i duhanit apo substancave tjera gjatë ndeshjes	200 €	100 €	50 €
51.2.	Hedhja e gjësendeve të buta në fushë të lojës, të cilat nuk mund të shkaktojnë lëndime	250 €	100 €	50 €
51.3.	Hedhja e gjësendeve të forta në fushë të cilat mund të shkaktojnë lëndime të lehta (si: shkrepëset, monedhat, shishet e plastikës, etj.)	500 €	200 €	100 €
51.4.	Hedhja e gjësendeve të forta të cilat mund të shkaktojnë lëndime të rënda (si: pjesë metalike, ulëset, etj.)	700 €	300 €	100 €
51.5.	Pështymja e lojtarëve dhe personave zyrtarë nga ana e shikuesve	400 €	200 €	100 €
51.6.	Animi dhe sjellja jospportive e shikuesve ndaj gjyqtarëve, lojtarëve dhe personave zyrtarë	600 €	150 €	100 €
51.7.	Animi dhe sjellja jospportive e shikuesve ndaj policisë, sigurimit, institucioneve, FBK, etj.	600 €	200 €	100 €
51.8.	Shpërfaqja dhe vendosja e pamfleteve me ofendime nacionale, fetare dhe racore, ose që nxisin dhunë apo urrejtje.	2.000 €	1.000 €	500 €
51.9.	Djegia e rekuizitave, shenjave identifikuese të shteteve, klubeve etj., ose të sendeve të tjera në objektin sportiv.	600 €	200 €	100 €
51.10.	Fishkëllima gjatë intonimit të himneve përkatëse, dhe intonimi i thirrjeve, tingujve ose sloganëve me përmbajtje raciste ose të një natyre intolerante që nxisin dhunë apo urrejtje	700 €	200 €	100 €
51.11.	Përdorimi i laserëve ose pajisjeve të ngjashme elektronike drejtuar lojtarëve apo personave të përfshirë në lojë ose e	400 €	100 €	50 €

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Automotive Sponsor: Youth Basketball supporters:





	çdo objekti tjetër që mund të ndikojë në lojën e tyre			
51.12.	Largimi në teshatore pas vërejtjes së parë nga gjyqtari i parë (5 minuta)	1000 €	100 €	50 €
51.13.	Hedhja/ndezja e mjeteve piroteknike në tribuna që vështirëson zhvillimin e ndeshjes	500 €	100 €	50 €
51.14.	Hedhja/ndezja e mjeteve piroteknike në parket apo afërsi të tij, që shkakton ndërprerje të ndeshjes (<15min) që mund të vazhdohet	700 €	200 €	100 €
51.15.	Hedhja/ndezja e mjeteve piroteknike në parket apo afërsi të tij, që shkakton ndërprerje të ndeshjes (>15min) që nuk mund të vazhdohet	1000€ dhe 1 ndeshje	1 ndeshje	1 ndeshje
51.16.	Animi jospportiv dhe sharja apo fyerja në kor e ekipeve, zyrtarëve dhe personave tjerë	700€	100 €	50 €
51.17.	Hyrja e personave jozyrtarë në fushë para, gjatë dhe pas ndeshjes, që shkakton ndërprerje të ndeshjes (<15min)	1000 € dhe 1 ndeshje	1 ndeshje	1 ndeshje
51.18.	Hyrja e personave jozyrtarë apo zyrtarë të klubit në lokalet e zyrtarëve të ndeshjes apo ekipeve apo në hapësirat e parapara për ta.	1000 €	200 €	50 €
51.19.	Sjellja agresive, fyerja, sharja e personave jozyrtarë ndaj personave zyrtarë të FBK	1000 €	200 €	50 €
51.20.	Tentimi i sulmit fizik ndaj lojtarëve, zyrtarëve të klubeve, gjyqtarëve, vëzhguesit apo personave zyrtarë nga persona jozyrtarë	1000 € dhe 1 ndeshje	1 ndeshje	1 ndeshje
51.21.	Realizimi i sulmit fizik me lëndim të lehtë të lojtarëve, zyrtarëve të klubeve, gjyqtarëve, vëzhguesit apo personave zyrtarë nga persona jozyrtarë	1500€ dhe 3 ndeshje	3 ndeshje	3 ndeshje
51.22.	Realizimi i sulmit fizik me lëndim të rëndë të lojtarëve, zyrtarëve të klubeve, gjyqtarëve, vëzhguesit apo personave zyrtarë nga persona jozyrtarë	10000 € dhe 5 ndeshje	4000 € dhe 5 ndeshje	2000 € dhe 5 ndeshje

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





51.23.	Shkaktimi i lëndimeve të lehta ndaj lojtarëve, zyrtarëve, gjyqtarëve apo vëzhguesve nga hedhjet e gjëseneve në fushën e lojës	5000 € dhe 2 ndeshje	2000€ dhe 2 ndeshje	1000 € dhe 2 ndeshje
51.24.	Shkaktimi i lëndimeve të rënda ndaj lojtarëve, zyrtarëve, gjyqtarëve apo vëzhguesve nga hedhjet e gjëseneve në fushën e lojës	10000 € dhe 4 ndeshje	4000 € dhe 4 ndeshje	2000 € dhe 4 ndeshje
51.25	Cenimi i fushës së lojës, hyrja në teren e personave të paautorizuar, ndërhyrja gjatë intervalit të ndeshjes, ndërhyrja para apo gjatë ceremonive hapëse dhe mbyllëse dhe veprime tjera të ngjashme që pamundësojnë ose pengojnë mbarëvajtjen e ndeshjes pa pasoja për pjesëmarrësit.	3000 € dhe 2 ndeshje	2000€ dhe 2 ndeshje	1000 € dhe 2 ndeshje

51.26. Për të gjitha rastet e cenimit të terrenit ose sigurisë së pjesëmarrësve të ndeshjes, përfshirë lojtarët, gjyqtarët, vëzhguesit, zyrtarët tjerë të deleguar apo personat zyrtarë të klubeve pjesëmarrëse; shfaqjes së animit të dhunshëm, fyes ose ofendues; krijimit të rrethanave të pasigurta për pjesëmarrësit e ndeshjes apo spektatorët; ndezjes apo shfrytëzimit të mjeteve piroteknike apo penguese të çfarëdo forme që vështirësojnë apo pamundësojnë zhvillimin e ndeshjes, gjyqtari kryesor mund të vendosë:

51.26.1. Të japë vërejtjen e parë për qetësim të situatës, përmes sistemit të zërimit publik;

51.26.2. Të japë vërejtjen e fundit dhe të tërhiqet në teshatore për një periudhë 15minutëshe për të pritur krijimin e kushteve për vazhdim të ndeshjes, apo për të zbrazur spektatorët dhe të gjithë personat jozyrtarë nga palestra me qëllim të krijimit të kushteve për vazhdimin e ndeshjes; ose

51.26.3. Të ndërpresë ndeshjen, në të gjitha rastet kur sipas vlerësimit të gjyqtarit të parë, pas konsultimit me vëzhguesin dhe/ose personat përgjegjës për siguri, nuk ekzistojnë dhe nuk mund të krijohen kushtet për të vazhduar ndeshjen brenda afatit 15minutësh, si dhe në të gjitha rastet kur është cenuar terreni dhe/ose sulmuar apo lënduar cilido akter i ndeshjes (lojtar, trajner, zyrtar i klubit, gjyqtar, vëzhgues, zyrtar i FBK apo i FIBA, apo persona zyrtarë tjerë).

51.27. Në rast kur nga shkeljet dhe sjelljet e listuara në këto Propozicione bëhet e pamundur zbrazja e palestrës dhe vazhdimi i ndeshjes gjatë pushimit prej 15min të paraparë për këtë qëllim, apo në rast të vlerësimit të gjyqtarit të parë lidhur me këtë,

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



ndeshja do të vazhdohet pa prezencën e shikuesve brenda 24 orësh nga momenti i ndërprerjes, ndërsa ekipi që ka shkaktuar ndërprerjen do të dënohet konform nenit 50 dhe me gjambat e përcaktuara në nenin 19.3 të këtyre Propozicioneve për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit të klubit tjetër, zyrtarëve të ndeshjes, ekipeve kompetente për realizimin televiziv dhe ofruesve të shërbimeve tjera.

NENI 52 - SHKELJET DHE DËNIMET PËR PJESËTARËT E EKIPEVE

A. SJELLJA JOSPORTIVE DHE REAGIMI NDAJ KUNDËRSHTARËVE DHE ZYRTARËVE				
Nr.	Përshkrimi i shkeljes	SL	SLF/L1	L1F/L2
52.1.	Gabimi teknik i lojtarit për sjellje josportive	100 €	30 €	20 €
52.2.	Gabimi teknik i lojtarit për inskenim (flopping)	50 €	===	===
52.3.	Gabimi përjashtues i lojtarit, trajnerit, zyrtarit (përveç GT+GJS)	300 €	150 €	75 €
52.4.	Gabimi teknik i trajnerit për sjellje josportive	150 €	30 €	20 €
52.5.	Komentimi apo kritikë ndaj vendimeve të gjyqtarëve nga lojtarët, trajnerët, zyrtarët e klub.	500 €	200 €	100 €
52.6.	Përjashtimi i personave zyrtarë që nuk janë në listë paraqitëse	600 €	300 €	100 €
52.7.	Sjellja josportive e konstatuar në bazë të fletëparaqitjes nga personat zyrtarë, transmetimi televiziv, xhirimet apo e shfaqur në prezencë të Komesarit të Garave, cilitdo anëtar të	200 € dhe 1 ndeshje	1 ndeshje	1 ndeshje

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





	Komisionit të Garave, Sekretarit apo Kryetarit të FBK-së			
52.8.	Sjellja agresive, fyese apo ofenduese e konstatuar në bazë të fletëparaqitjes nga personat zyrtarë, transmetimi televiziv, xhirimet apo e shfaqur në prezencë të Komisarit të Garave, cilitdo anëtar të Komisionit të Garave, Sekretarit apo Kryetarit të FBK-së	1000 € dhe 3 ndeshje	300 € dhe 3 ndeshje	150 € dhe 3 ndeshje
B. PËRPJEKJA PËR REALIZIM DHE REALIZIMI I SULMIT FIZIK APO SHKAKTIMI I LËNDIMIT				
52.9.	Sjellja josportive, me përpjekje të sulmit fizik dhe pështyjma ndaj lojtarit kundërshtar, personit zyrtar të klubit apo personave zyrtarë para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes.	1000 € dhe 1 ndeshje	300 € dhe 1 ndeshje	150 € dhe 1 ndeshje
52.10.	Pjesëmarrja në rrahje apo kacafytje e lojtarëve apo zyrtarëve të ekipeve kundërshtare, pa përfshirje të personave të tretë, para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes.	1000 € dhe 1 ndeshje	300 € dhe 1 ndeshje	150 € dhe 1 ndeshje
52.11.	Nxitja apo iniciimi i rrahjes apo kacafytjes mes lojtarëve apo zyrtarëve të ekipeve kundërshtare, pa përfshirje të personave të tretë, para,	2000 € dhe 3 ndeshje	600 € dhe 3 ndeshje	300 € dhe 3 ndeshje

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





	gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes.			
52.12.	Realizimi i sulmit fizik ndaj lojtarëve, trajnerëve, zyrtarëve apo përfaqësuesve të ekipeve apo personave zyrtarë të deleguar në ndeshje apo personave zyrtarë të FBK pa pasoja fizike	2000 € dhe 3 ndeshje	600 € dhe 3 ndeshje	300 € dhe 3 ndeshje
52.13.	Realizimi i sulmit fizik ndaj lojtarëve, trajnerëve, zyrtarëve apo përfaqësuesve të ekipeve apo personave zyrtarë të deleguar në ndeshje apo personave zyrtarë të FBK që rezultojnë me lëndime të lehta trupore	5000 € dhe 5 ndeshje	2000€ dhe 5 ndeshje	1000 € dhe 5 ndeshje
52.14.	Realizimi i sulmit fizik ndaj lojtarëve, trajnerëve, zyrtarëve apo përfaqësuesve të ekipeve apo personave zyrtarë të deleguar në ndeshje apo personave zyrtarë të FBK që rezultojnë me lëndime të rënda trupore.	10000 € dhe 10 ndeshje	4000 € dhe 10 ndeshje	2000€ dhe 10 ndeshje

52.15. Për të gjitha instancat e përkruara në nenet 52.9 - 52.14 më sipër, dënimi i përkruar me ndeshje mos-lojë për individët e përfshirë do të përcillet edhe me dënim të terrenit ose zhvillim të ndeshje pa praninë e spektatorëve prej 1-8 ndeshje varësisht nga pesha e incidentit.

52.16. Në rast të përsëritjes së dënimeve sipas neneve 52.9 - 52.14 nga cilido pjesëtar i klubeve, i njëjti do të suspendohet deri në fund të edicionit garues dhe ndaj të tyre do të hapet me automatizëm procedurë disiplinore.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





52.17. Për të gjitha rastet e realizimit të sulmit fizik ndaj akterëve të ndeshjes apo lëndimit të pjesëtarëve të ekipeve mund të hapet edhe procedurë disiplinore dhe për këtë të njoftohen autoritetet përgjegjëse.

52.18. Përveç dënimit mandatar të rregulluar me nenin 52.14, të gjithë personat e përfshirë në realizimin e sulmit fizik mund t'i nënshtrohen procedurës disiplinore dhe rrezikojnë ndalesën e ushtrimit të detyrës në periudha të gjata apo përjashtimin e përjetshëm nga ushtrimi i çfarëdo detyre në basketboll.

52.19. Për të gjitha instancat e përshkruara në nenet 52.1 - 52.8 më sipër, dënimet ndaj personave që kanë shkaktuar shkeljet do të dyfishohen pas herës së tretë të përsëritjes së shkeljes.

52.20. Me shqiptimin e dënimeve sipas këtij neni, Komisioni i Garave apo zyrtarët tjerë përkatës mund të kërkojnë edhe hapjen e procedurës disiplinore ndaj kryerësve të shkeljes.

NENI 53 - PËRBËRJA E EKIPIT

Nr.	Përshkrimi i shkeljes	SL	SLF/L1	L1F/L2
53.1.	Nëse ekipi nuk paraqitet në përbërjen më të mirë (sipas nenit 13)	1000 €	300 €	100 €
53.2.	Nëse ekipi paraqitet me më pak se 10 lojtarë në ndeshje	500 €	150 €	50 €
53.3.	Nëse ndonjëri prej personave zyrtarë të paraqitet me veshje të papërshtatshme	100 €	50 €	20 €

53.4 Për të gjitha instancat e përshkruara në nenin 53 më sipër, dënimet ndaj klubeve që kanë shkaktuar shkeljet do të dyfishohen pas herës së dytë të përsëritjes së shkeljes.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 54 - APARATURA E ZËRIMIT, INSTRUMENTET MUZIKORE

Nr.	Përshkrimi i shkeljes	SL	SLF/L1	L1F/L2
54.1.	Mungesa e zërimit për nevoja zyrtare (për prezantimin e ekipeve, personave zyrtarë dhe vërejtja me anë të speakerit zyrtar)	300 €	200 €	====
54.2.	Lëshimi i muzikës në sallë nëpërmjet të aparaturës së zërimit gjatë kohës së ndeshjes (koha dhe topi i gjallë)	200 €	100 €	50 €
54.3.	Hyrja në fushë e maskotës së klubit gjatë kohës së lojës apo gjatë ndërprerjeve të shkurta pa lejen e gjyqtarëve	200 €	100 €	50 €
54.4.	Përdorimi i zërimit për nxitjen e shikuesve për anim, marketing politik	500 €	200 €	100 €
54.5.	Përdorimi/lëshimi i muzikës ose përdorimi i mikrofonit me qëllim nxitjen e ofendimeve në kor para dhe gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes	500 €	200 €	100 €
54.6.	Përdorimi i sirenavë dhe mjeteve tjera të cilat bëjnë zhurmë me të cilat pengohet mbarëvajtja e ndeshjes	200 €	100 €	50 €

54.7. Për të gjitha instancat e përshkruara në nenin 54 më sipër, dënimet ndaj klubeve që kanë shkaktuar shkeljet do të dyfishohen pas herës së dytë të përsëritjes së shkeljes.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





NENI 55 - MARKETINGU

Nr.	Përshkrimi i shkeljes	SL	SLF/L1	L1F/L2
55.1.	Mosrespektimi i dispozitave të Rregullores së Marketingut të FBK	2.000 €	500 €	250 €
55.2.	Mosshfrytëzimi i logos së ligës në fanella	1.000 €	250 €	100 €
55.3.	Mungesa pa arsye e lojtarëve, trajnerëve dhe zyrtarëve tjerë në aktivitetet promovuese të FBK	1 ndeshje	1 ndeshje	1 ndeshje

55.4. Për të gjitha instancat e përshkruara në nenin 55 më sipër, dënimet ndaj klubeve dhe pjesëtarëve të tyre që kanë shkaktuar shkeljet do të dyfishohen pas herës së tretë të përsëritjes së shkeljes.

NENI 56 - VËZHguesI, GJYQTARËT DHE GJYQTARËT NDIHMËS

56.1.	Kryerja e papërgjegjshme e detyrës, mos zbatimi i udhëzimeve dhe vendimeve të Komisarit të Garave, Komisionit të Garave, Propozicioneve të Garave, rregullave zyrtare të lojës	2 - 4 ndeshje
56.2.	Paraqitja jo objektive e fakteve në raport dhe fshehja e fakteve	2 ndeshje dhe
56.3.	Dorëzimi jo me kohë i raportit të ndeshjes nga ana e vëzhguesit	4 ndeshje
56.4.	Përdorimi i veshjes jo të rregullt për ndarjen e drejtësisë, mungesa e ndonjë pjese të veshjes (uniformës) apo të veshjes së ndryshme nga kolegët e tij	2 ndeshje
56.5.	Mosparaqitja me kohë në ndeshje (1 orë para fillimit të ndeshjes) vonesa <15min	1 ndeshje
56.6.	Mosparaqitja me kohë në ndeshje (1 orë para fillimit të ndeshjes) vonesa >15min	2 ndeshje

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





56.7.	Mosparaqitja me kohë në fushën e lojës (20 minuta para fillimit të ndeshjes) <5min	1 ndeshje
56.8.	Mosparaqitja me kohë në fushën e lojës (20 minuta para fillimit të ndeshjes) >5min	3 ndeshje
56.9.	Abstenimi nga ndeshja e nominuar.	Largimi nga lista për edicionin garues
56.10.	Konsumimi i alkoolit në ditën e ndarjes së drejtësisë, para fillimit të ndeshjes	5 ndeshje
56.11.	Ndarja jo e mirë e drejtësisë sipas raportit të ndeshjes apo video xhirimit të ndeshjes.	2 ndeshje
56.12.	Ndarja e dobët e drejtësisë sipas raportit të ndeshjes apo video xhirimit të ndeshjes	4 ndeshje
56.13.	Bërja e gabimit material të rregullave të lojës, pa ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të ndeshjes	4 ndeshje dhe
56.14.	Mos dërgimi i vlerësimit nga gjyqtarët e nominuar në Superligë brenda afatit.	1 ndeshje
56.15.	Bërja e gabimit material të rregullave të lojës, me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtarë të ndeshjes	10 ndeshje
56.16.	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili tenton ose realizon sulmin fizik ndaj lojtarit, trajnerit ose personit zyrtarë të skuadrës	Largimi nga lista për edicionin garues
56.17.	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili tenton ose realizon sulmin fizik ndaj kolegut apo vëzhguesit ose vëzhguesit ndaj gjyqtarit	Largimi nga lista për edicionin garues
56.18.	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili nuk merr pjesë në seminarët dhe testimet e obliguara para dhe gjatë edicionit garues	Largimi nga lista për edicionin garues
56.19.	Gjyqtari i dënuar tri (3)herë për shkak të mos respektimit të Propozicioneve	Largimi nga lista për edicionin garues

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





56.20.	Gjyqtari apo vëzhguesi i cili publikisht kritikon vendimet e FBK, punën e Komisarit të Garave dhe Komisioneve të FBK	Largimi nga lista për edicionin garues
56.21.	Sjellja e pahijshme dhe joprofesionale e gjyqtarëve para, gjatë apo pas ndeshjes	1 ndeshje
56.22.	Shfrytëzimi i fjalorit ofendues, fyes, denigrues apo të papërshtatshëm ndaj akterëve të ndeshjes	2 ndeshje

56.23 Për të gjitha shkeljet e shkaktuara nga gjyqtarët, gjyqtarët ndihmës, vëzhguesit, zyrtarët e FBK dhe personat tjerë të deleguar nga FBK për ofrim të shërbimeve gjatë ndeshjeve, Komisioni i Garave dhe organet tjera të FBK mund të hapin procedurë disiplinore.

NENI 57 - SHQIPTIMI I DËNIMEVE DHE MASAVE TJERA NDËSHKIMORE

57.1. Komisioni i Garave në shkallë të parë i shqipton dënimet për shkeljet e përcaktuara me këto Propozicione të Garave.

57.2. Komisioni i Garave mund të shqiptojë dënime sipas këtyre kriterëve për akterët e ndeshjeve edhe pse ata nuk janë shënuar dhe nuk janë sanksionuar nga ana e vëzhguesit dhe gjyqtarët, por është konstatuar nga video xhirimet e ndeshjes apo prezencës së tyre në ndeshje.

57.3. Për shkeljet e rënda të lojtarëve, trajnerëve, përfaqësuesve zyrtarë të klubeve dhe përfaqësuesve zyrtarë në ndeshje, dënimet shqiptohen edhe në bazë të Rregullores Disiplinore të FBK-së.

57.4. Dënimet e shqiptuara për ndalimin e paraqitjes në ndeshje, gjegjësisht kryerjes së detyrës në numër të caktuar të ndeshjeve, zbatohet sipas tempos së delegimit , në pajtim me orarin dhe kalendarin e garave kampionale dhe të kupës.

57.5. Në rast që dënimi i shqiptuar nuk është shërbyer në edicionin garues ai do të bartet në edicionin e ardhshëm garues pa marrë parasysh në ndërrimin eventual të shkallës së garave, klubit apo emërimit.

57.6. Personit të cilit i është shqiptuar dënimi kohor, gjatë kohës së mbajtjes së dënimit nuk mund të ushtrojë asnjë detyrë në sportin e basketbollit. Dënimi i shqiptuar kohor nga trupat

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





e autorizuar botërore, evropiane dhe regjionale dhe Liga Unike do të vlejë edhe në ndeshjet e zhvilluara në FBK.

57.7. Në rast të shqiptimit të dënimit të një shkelësi, për dy apo më tepër shkelje në një ndeshje, dënimi i tërësishëm duhet të jetë diç më i vogël se sa mbledhja e të gjitha dënimeve.

57.8. Dënime mandatare konsiderohen edhe ato të shqiptuara për shkelje të rregullave të anit-dopingut nga organet kompetente, qoftë KosADA, WADA apo organ i FIBA-s.

57.9. Nëse Komisioni i Garave (organi i cili udhëheq garat), në procedurën e zbatuar, në mënyrë të pakontestueshme e vërteton se rezultati i ndeshjes në mes të dy skuadrave është kurdisur, atëherë të dyja skuadrat largohen nga garat dhe bien në një nivel më të ulët të garave.

57.10. Shqiptimi i çfarëdo dënimi sipas këtyre Propozicioneve mund të shërbejë si bazë për hapjen e procedurës disiplinore ndaj ekipit apo pjesëtarit shkelës të tyre.

NENI 58 - REGJISTRIMI I E NDESHJES ME REZULTAT ZYRTAR

58.1. Nëse ekipi në ndeshje paraqitet me lojtarin i cili nuk ka të drejtë paraqitjeje, është i pezulluar, apo ekipi nuk posedon licencën e lëshuar nga komisioni për regjistrim Komisioni i Garave apo ndeshjen e udhëheqë trajneri i dënuar, ekipi e humbë ndeshjen me rezultat zyrtarë 20:0 dhe nuk merr asnjë pikë.

58.2. Nëse ekipi nuk paraqitet pa arsye për zhvillimin e ndeshjes, ndeshjen e humb me rezultat 20:0 dhe nuk merr asnjë pikë.

58.3. Ekipi që në një edicion garues humb dy ndeshje me rezultat zyrtar i njëjti do të largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në vitin e ardhshëm garues do të paraqitet në një rang më të ulët garimi. Në rast të largimit të ekipit nga garat sipas këtij paragrafi, do të vlejë rregullimet në vijim:

58.3.1. Nëse klubi i larguar ka zhvilluar më pak se gjysmën e ndeshjeve, të gjitha rezultatet të cilat i ka arritur do të anulohen dhe të gjitha ndeshjet e regjistrohen 20:0.

58.3.2. Nëse klubi ka zhvilluar gjysmën-apo më tepër se gjysmën e ndeshjeve në garat nga e cila është larguar, ato ndeshje do të regjistrohen me rezultatin e arritur, deri sa ndeshjet e mbetura deri në fund të edicionit do të regjistrohen me 20:0 dhe ekipit nuk i takon pikët për ato ndeshje.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





58.4. Ekipi që e braktisë në mënyrë arbitrare fushën e lojës para përfundimit të ndeshjes dhe nuk kthehet për vazhdimin e ndeshjes pas kohës së time-out të mbetur për atë periudhë apo në ftesë të gjyqtarit të parë, do të humbë lojën me rezultat zyrtar, do të largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në edicionin e ardhshëm garues do të bëjë gara në një nivel më të ulët të garave.

58.5. Ekipi i cili pa arsye nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjeve të play out-it të cilat zhvillohen në dy ndeshje me rezultat të përgjithshëm (brenda dhe si mysafirë) apo në mënyrë arbitrare e braktisë fushën dhe nuk kthehet për të vazhduar ndeshjen në ftesë të gjyqtarit të parë, humb të gjitha ndeshjet në fazën e garave të play out-it dhe në edicionin e ardhshëm garues do të bëjë gara në një nivel më të ulët të garave.

58.6. Nëse ekipi pa arsye nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjes së play-offit "më i mirë nga tri ndeshje" apo në mënyrë arbitrare e braktisë fushën dhe nuk kthehet për të vazhduar ndeshjen në ftesë të gjyqtarit të parë, i humb të gjitha ndeshjet në fazën e garave të play-off-it dhe në edicionin e ardhshëm garues do të bëjë gara në një shkallë më të ulët të garave.

58.7. Nëse ekipi pa arsye nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjes së play-offit "më i mirë nga pesë ndeshje" apo e braktisë ndeshjen, ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar 20:0 në favor të ekipit kundërshtar dhe ekipi do të dënohet me 5.000€. Në rast të përsëritjes (gjatë një edicioni), ekipi do të dënohet me 10.000€ dhe i humb të gjitha ndeshjet në fazën e mbetur të garave të play-off-it dhe në edicionin e ardhshëm garues do të bëjë gara në një shkallë më të ulët të garave.

58.8. Nëse vëzhguesi dhe gjyqtarët marrin vendim mbi ndërprerjen e ndeshjes pasi nuk ekzistojnë kushtet mbi vazhdimin e saj për shkak të tollovisë (tifozeve) të shkaktuara, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar 20:0 në të mirë të skuadrës mysafire, ndërsa skuadrës vendase i takon zero (0) pikë, me përjashtim nëse në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet se ndërprerja është shkaktuar me fajin e skuadrës mysafire. Në këtë rast skuadra mysafire e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20 dhe i takon zero (0) pikë. Ndeshja e ndërprerë për shkak të incidentit të shkaktuar nga ana e lojtarëve dhe përfaqësuesve zyrtarë të ndeshjes, do të regjistrohet me rezultat 2:0 kundër ekipit që ka shkaktuar ndërprerjen e ndeshjes dhe nuk merr pikë të paraparë për humbje.

58.9. Nëse skuadra gjatë lojës mbetet me më pak se dy (2) lojtarë në fushë e humb ndeshjen për shkak të mos përfundimit të lojës. Nëse skuadra, e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen nuk udhëheq në rezultat, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat 2:0 në të mirë të saj. Nëse skuadra e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen udhëheq në rezultat, atëherë

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





rezultati deri në kohën e ndërprerjes mbetet i vlefshëm. Skuadra e cila e humb ndeshjen në këtë mënyrë e fiton një (1) pikë në tabelën e klasifikimit.

NENI 59 - NDALESA PËR ZHVILLIMIN E NDESHJES NË FUSHËN E EKIPIT TË DËNUAR

59.1. Në rast që klubi vendës është dënuar me ndalesë të zhvillimit të ndeshjeve në fushën e tij, duhet:

59.1.1. Që të caktojë vendin për zhvillimin e ndeshjes i cili është në largësi më së paku prej 30km nga vendi për të cilin është caktuar dënimi dhe palestrën e cila është e licencuar për zhvillimin e ndeshjeve kampionale.

59.1.2. Fusha e cila është caktuar për zhvillimin e ndeshjes mund të jetë edhe në qytetin nga është kundërshtari por nuk guxon të zhvillohet në sallën ku ekipi kundërshtar paraqitet si ekip vendase.

59.2. Nëse ndeshja zhvillohet në fushën e cila në krahasim me fushën e dënuar është në distancë më të madhe, ekipe vendëse është e obliguar që ekipit mik t'ia kompensojë ndryshimin e shpenzimeve të udhëtimit. Ndryshimin e shpenzimeve të udhëtimit e përcakton Komisioni i Garave pas pranimit të dokumentacionit komplet për mënyrën e udhëtimit të ekipit mik.

NENI 60 - NDALESA E PREZENCËS SË SHIKUESVE

60.1. Në rast që ekipi vendës-organizatori është dënuar që ndeshjet vendase t'i zhvillojnë pa prezencën e shikuesve, i njëjti obligohet:

60.1.1. Që të sigurojë palestrën e regjistruar dhe licencuar për nivelin përkatës të garave, në pajtim me dispozitat e nenit 59; dhe

60.1.2. Që të sigurojë që në palestër, përveç ekipeve të jenë të pranishëm vetëm personat zyrtarë, kujdestarët, organi për sigurim dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit publik.

60.2. Delegati i ndeshjes është i autorizuar që të verifikojë/kërkojë nga organizatori (vendosjen e prezencës së kufizuar të shikuesve) largimin e të gjithë personave jozyrtarë nga palestra, para apo nëse është e nevojshme edhe gjatë ndeshjes kurse vëzhguesi nuk guxon të lejojë që ndeshja të fillojë pa u plotësuar këto kushte.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





60.3. FBK ruan të drejtën e dërgimit të ftesave zyrtare për pjesëmarrjen e të ftuarve të vet në ndeshjet e tilla.

NENI 61 - EVIDENCA E DËNIMEVE TË SHQIPTUARA

61.1. Komisioni i Garave dhe administrata janë të obliguar që nëpërmjet të informatorëve të informojnë për dënimet e shqiptuara sipas xhirove apo kohës me terminet e sakta të caktuara.

61.2. Në rastet urgjente informimi kryhet nëpërmjet postës elektronike, kurse përmbajtja në informatorin e ardhshëm.

61.3. Komisioni i Garave para çdo edicioni garues njofton për obligimet e klubeve dhe dënimet nga edicioni i kaluar garues. Në të kundërtën klubet mbajnë përgjegjësi për lëshimet eventuale sipas këtij qëndrimi.

61.4. FBK do të mbajë evidencën e plotë të dënimeve të shqiptuara në formë elektronike dhe do ta vë këtë në dispozicion të palëve me interes, sipas kërkesës.

NENI 62 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

62.1. Të gjitha rastet të cilat nuk janë paraparë, apo nuk janë përfshirë në këto Propozicione, Komisioni i Garave i zgjedh me zbatimin e akteve të përgjithshme FBK-së dhe të Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit-FIBA.

62.2. Propozicionet e Garave i miraton Bordi i FBK-së në propozim të Komisionit të Garave.

62.3. Ndërrimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve miratohen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të tyre. Gjatë një stinori garues, Propozicionet mund të ndryshohen vetëm për raste që kërkojnë trajtim urgjent apo në rast të shfaqjes së rrethanave të jashtëzakonshme.

62.4. Interpretimin e këtyre Propozicioneve e jep Bordi i FBK-së në frymën në të cilën ka miratuar këto Propozicione, në mënyre direkte apo nëpërmjet të Komisionit të Garave.

62.5. Bordi i FBK-së autorizon dhe obligon Komisionin e Garave të FBK-së që të përpunojë dhe të jep tekstin e konsoliduar të Propozicioneve të Garave, në pajtim me frymën e përcaktuar dhe miratuar nga Bordi i FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

62.6. Këto Propozicione të Garave janë miratuar nga Bordi i FBK-së dhe do të zbatohen për edicionin garues 2023/2024.

Arben **FETAHU**
Kryetar



Federata e Basketbollit të Kosovës
Prishtinë, 30.08.2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:

